



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 20.04.2022, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Raportimi i veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021

**Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Edmond Spaho.

**Mungojnë:**

Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj, Agron Shehi, Bujar Leskaj.

**Të ftuar:**

Arben Shehu – Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Marjola Llanaj - Drejtor i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Valbona Gaxha - Sekretar i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Gjovalin Preçi - Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Endi Cekani - Drejtor i Kabinetit në Kontrollin e Lartë të Shtetit

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Para se të fillojmë mbledhjen, verifikojmë kuorumin.

Kuorumi është. Medien mund ta thërrasësh.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Në rendin e ditës sot, sikundër jeni në dijeni, kemi raportimin e veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021. Kemi vendosur dy relatorë, një praktikë e re, që për mua është një precedent pozitiv. Relatore kemi zonjën Enslemvera Zake dhe zonjën Emilia Koliqi. Për të gjitha institucionet e pavarura kemi caktuar dy relatorë, një nga maxhoranca dhe një nga opozita.

Kemi edhe një pikë të dytë, miratimin e draftrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës, për të cilën besoj se ka gjëra shtesë. Unë nuk besoj se do të jemi në gjendje ta miratojmë sot për shkak të dy-tri gjerave që kanë dalë dhe duhen rakorduar. Gjithsesi, nuk jam në dijeni të propozimeve për shtesa apo për rregullime. Janë vetëm dy?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk ka. Në rregull!

Nuk kanë ardhur as nga deputetët? Nuk ka.

Në rregull!

Atëherë, fillojmë me raportimin e veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021.

Të ftuar kemi kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Arben Shehu, i cili shoqërohet nga zonja Mariola Llanaj, drejtoreshë e Përgjithshme, zonja Valbona Gaxha, sekretare e Përgjithshme dhe zoti Gjovalin Preçi, drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit, të cilëve iu uroj mirëseardhjen në komision!

Po ia kaloj fjalën zotit Shehu për të prezantuar veprimtarinë e raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021. Më pas do të vazhdojmë si zakonisht me relatorët, me pyetjet dhe me fazën e diskutimeve. Në një mbledhje tjetër do të njoftojmë edhe për miratimin e rezolutës për veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Atëherë, fjala për ju, zoti Shehu.

**Arben Shehu** – Faleminderit!

I nderuar Kryetar i Komisionit,

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Raporti vjetor i performancës së Kontrollit të Lartë të Shtetit përmbledh veprimtarinë e institucionit për vitin 2021, vit në të cilin, pavarësisht vështirësive të shkaktuara nga kriza mbarë botërore e Covid-19 në të gjitha institucionet publike, veprimtaria e KLSH-së në përgjithësi dhe asaj audituese në veçanti, i është përshtatur këtij mjedisi dinamik.

Ne kemi qenë në gjendje të mbajmë një nivel të lartë të mbulimit me auditim, me cilësinë që parlamenti dhe taksapaguesit presin nga KLSH-ja, kjo në përmbushje të detyrimit kushtetues dhe misionit të institucionit në dobi të mirëqeverisjes së fondeve publike me impakt rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Gjatë vitit 2021 puna jonë ka vijuar duke pasur në vëmendje që çdo auditim të jetë një vlerë e shtuar për çdo institucion që auditohet, duke kontribuar kështu në rritjen e besimit tek institucioni ynë, për rolin e tij në rritjen e përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike dhe rritjen e transparencës ndaj taksapaguesve shqiptarë.

Për vitin 2021 raporti vjetor i performancës paraqet rezultatet e punës audituese bazuar në 158 auditime të evaduara sipas llojshmërisë së tyre, ushtruar në 205 subjekte, me synim dhënien e opinionit për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe menaxhimin e parasë publike.

Nuk ka dyshim se pandemia e Covid-19 pati një ndikim tepër të madh në menaxhimin financiar të shtetit. KLSH-ja vlerëson se pavarësisht kësaj, kjo pandemi shërbeu për të na vënë në dukje problematika të cilat prej një kohë të gjatë kanë ndikuar në menaxhimin e fondeve publike dhe burimeve në Republikën e Shqipërisë.

Ne u ndeshëm me një periudhë të gjatë dhe të vështirë, ku roli i shtetit duhet të jetë më i rëndësishëm se kurrë, në ndihmë të shtresave që kanë nevojë për mbështetje dhe asistencë, pasi kjo krizë ishte me impakt shëndetësor, ekonomik, social dhe psikologjik.

Pa mohuar një sërë vendimesh nga qeveria dhe nga parlamenti, si reagim i menjëhershëm për situatën, duhet të themi se fushat kryesore: shëndetësia, arsimi dhe zhvillimi i infrastrukturës, janë të mbingarkuara me procedura burokratike, të cilat ngadalësojnë procesin e zbatimit, krahasuar me reagimin e menjëhershëm në vendimmarrje.

Nga auditimet u konstatua mungesë e koordinimit, legjislacion jo i thjeshtë për t'u aplikuar, komunikim i vonuar dhe shërbime jo në nivelin e kërkuar, rezerva e kapacitete të nënvlerësuara për përballimin e krizave, të cilat janë tregues për vëmendje të shtuar dhe një qasje më dinamike dhe efikase në situata krizash, pikërisht në këto fusha nga të cilat varemi në kohë të vështira.

Nuk dëshiroj gjithsesi që kjo parathënie e një veprimtarie të mbushur me të dhëna dhe gjetje, të përfundojë si një lajm i radhës për mediet, por duhet parë nga institucionet si një mundësi për të zgjuar përgjegjësinë dhe qasjen, për të dhënë zgjidhje në situata të vështira.

Në këtë mënyrë ne synojmë që ky raport vjetor 2021 i KLSH-së, të ndihmojë këto institucione në këtë drejtim, duke u përgjigjur me një nivel më të lartë të zbatimit të rekomandimeve dhe masave të propozuara nga KLSH-ja, shpesh të përsëritura, për një përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit financiar dhe ligjor. Vizioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si agjent i Kuvendit, është në të njëjtën linjë me moton e institucioneve ndërkombëtare të auditimit ku auditimi kombëtar është në shërbim të qeverisjes kombëtare dhe jo të qeverive.

Bazuar mbi këtë vizion dhe filozofi veprimtaria jonë gjatë vitit 2021 ka synuar përmirësimin e menaxhimit financiar, administrimit publik dhe të kontrolleve të brendshme, duke kontribuar në qeverisjen e mirë, promovimin e llogaridhënies dhe luftës kundër korrupsionit, duke i kthyer në një kulturë pune të vazhdueshme për të gjithë audituesit e KLSH-së.

KLSH-ja si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar, objektivitetin dhe pavarësinë institucionale e siguron përmes ushtrimit të mandatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj dhe në pajtueshmëri me standardet profesionale të auditimit, Kodin e Etikës dhe normat e sjelljes profesionale, duke qenë një zë publik që bën thirrje për profesionalizëm dhe përgjegjshmëri të lartë të administratës shtetërore.

Më lejoni në vijim të përcjell në mënyrë më konkrete shifrat mbi aktivitetin e ushtruar përgjatë vitit 2021.

Siç e përmenda dhe më lart, KLSH-ja ka mundur të vlerësojë dhe të japë opinion për integritetin e proceseve dhe procedurave, nëpërmjet mbulimit me auditim të të gjithë aspekteve të domosdoshme, ku rezultojnë të evaduar 158 auditime të kryera në institucionet e qeverisjes së përgjithshme, në njësitë e pushtetit vendor, në shoqëritë me kapital shtetëror etj.

Në linjë me sugjerimet dhe rekomandimet e raportprogresit të BE-së për auditimin e jashtëm publik, si dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, është shtuar vëmendja ndaj auditimeve financiare me dhënie opinion mbi rregullshmërinë dhe besueshmërinë e pasqyrave dhe deklaratave financiare të subjekteve të audituara, në referencë me standardin ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”. Konkretisht, për vitin 2021 u përbyllën 21 auditime financiare me dhënie opinion dhe 37 opinione financiare të dhëna nga 41 auditimet e kombinuara: financiare dhe përputhshmërie.

Nga këto auditime në 17 raste ose 29 % prej tyre janë dhënë opinione të pakualifikuara; në 25 raste ose 43% prej tyre janë dhënë opinione të kualifikuara, ndërsa në

16 raste ose 27%, grupi i auditimit të KLSH-së ka arritur në konkluzionin e një opinionit të kundërt.

Sa i takon auditimeve të përputhshmërisë, për periudhën janar – dhjetor 2021, KLSH-ja ka evaduar 56 auditime të konkluduara me opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit, pa përfshirë këtu 37 opinione përputhshmërie të dhëna në auditimet e kombinuara.

Sipas cilësisë së opinionit, në 10 raste janë dhënë opinione të pakualifikuara; në 56 raste opinionit ka qenë i kualifikuar, ndërsa në 27 raste konkluzioni ka qenë për një opinion të kundërt.

Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet e ndërmarra për përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës. Kështu, për vitin 2021 numri i auditimeve të performancës u rrit në 18, duke prekur tema dhe çështje me impakt të ndjeshëm social si në fushën e shëndetësisë; çështje me impakt social-ekonomik; në fushën e bujqësisë; në fushën e administrimit dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme publike dhe në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Me objektivin e parë të strategjisë së zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, institucioni ynë provoi të kalonte me sukses sprovën drejt një zhvillimi ambicioz, atë të auditimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit, si një lloj i veçantë auditimi . Për vitin 2021 janë realizuar 7 auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, ndërkohë që është punuar për të miratuar kuadrin e plotë rregullativ dhe hartuar udhëzuesit metodologjikë të nevojshëm, mbi të cilët realizohen auditime të tilla mjaft komplekse. Indikatorit i dobishmërisë së auditimeve të realizuara për vitin 2021 rezultoi se është 56,3, çka do të thotë se për çdo një lek të shpenzuar për KLSH-në nga buxheti i shtetit, janë zbuluar 56,3 lekë dëme financiare. Treguesi i mësipërm i dobisë së auditimit është llogaritur si raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH-ja në vlerën 19.2 miliardë lekë me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 340.3 milionë lekë.

Edhe për këtë vit raportues puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku, por edhe që vijnë të shfaqin ndër vite problematika në lidhje me menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e financave publike, të cilat në vlerësimin tonë kërkojnë një vëmendje të shtuar të Kuvendit dhe të qeverisë.

Më konkretisht, rezultatet e auditimeve të vitit 2021 materializohen, si vijon:

Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën prej 19,2 miliardë lekësh. Edhe këtë vit, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me keq administrimin e të

ardhurave; menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keqadministrimin e pronës shtetërore e ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe inefficiencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, etj.

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 54,8 miliardë lekësh, ose afërsisht 452 milionë euro, nga e cila:

11 miliardë lekë, ose 91 milionë euro në fushën e të ardhurave;

43,8 miliardë lekë ose 361 milionë euro në fushën e shpenzimeve të kryera jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, si dhe në kushtet e shkeljeve të disiplinës buxhetore të parashikuara lidhur me programimin dhe realizimin e shpenzimeve dhe procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Rezultatet e mësipërme të auditimeve të KLSH-së synojnë të ndikojnë në perceptimin e publikut mbi nivelin e korrupsionit, i cili mbetet një nga problemet më serioze në zhvillimet demokratike të vendit, dhe që cenon besimin publik, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien dhe zhvillimin në vend.

Gjithashtu, bazuar në zbulimet e auditimeve të KLSH-së për vitin 2021 shkeljet me dëm ekonomik për parregullsi dhe shkelje financiare, fatkeqësisht tregojnë se aktiviteti qeverisës vazhdon të shfaqë problematika në keqadministrimin dhe keqmenaxhimin e fondeve dhe të pasurisë publike, duke shmangur përgjegjësinë e llogaridhënien.

Referuar analizës së gjetjeve kryesore për vitin 2021, konstatohet se:

dëmi ekonomik në fushën e të ardhurave, konstatohet kryesisht në sistemin e doganave dhe tatimeve në shumën e përgjithshme prej 14,5 miliardë lekësh.

Vlera më e konsiderueshme në këtë kategori është evidentuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave nga trajtimi me transaksion të mallrave të importuar dhe keqklasifikimi i Kodit Doganor të artikujve të importuar, me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, nga pasaktësitë në llogaritjen e elementëve të vlerës për efekt taksimi doganor, nga vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me bazën ligjore të Kodit Doganor të RSH-së, etj.

Gjithashtu, shkeljet me dëm ekonomik në fushën e të ardhurave kanë rezultuar edhe në sektorin e tatimtaksave, në vlerën e përgjithshme prej 2,35 miliardë lekësh, kjo në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në drejtorinë rajonale tatimore Fier.

Dëmi ekonomik në fushën e shpenzimeve ka rezultuar në shumën prej 1,75 miliardë lekësh, e cila përfshin shpenzimet për paga dhe sigurime; shpenzimet për investime; ato operative dhe shpenzime të tjera.

Dëmi ekonomik i evidentuar në shpenzimet për investime përbën 21% të dëmit në fushën e shpenzimeve. Ky dëm ekonomik ka rezultuar në fushën e prokurimit të nevojave për mallra/shërbime/investime publike, si në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ashtu edhe në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.

KLSH-ja ka evidentuar problematika të shumta në procedurat e prokurimit:

që nga planifikimi jo të drejtë të nevojave, por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;

Ilojet e procedurave të zgjedhura me tendencë drejt atyre me negociim të drejtpërdrejtë;

përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike të ekzagjeruara jo në raport me objektin e kontratës;

të vepruarit e zyrtarëve të prokurimit me dy standarde etj, duke sjellë për pasojë mungesën e konkurrencës së nevojshme.

Mangësitë i referohen zbatimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike, që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik, për shkak edhe të mangësive profesionale të zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit.

Mangësi në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit në të gjithë fazat e tij, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik;. Nga vlera e mësipërme e dëmit ekonomik, 15% u përket zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.

Abuzimet në fushën e prokurimit me fondet publike në thelb janë dhe më të larta nga manipulimi ligjor, pasi ekziston dhe një shkallë dëmi e pamatshme nga prokurimet me një ofertues dhe me procedurat e negociimeve pa shpallje. (Kujtojmë këtu se për një pjesë të konsiderueshme të prokurimeve me prokurim direkt ose me një ofertues, nuk është metodologjikisht dhe praktikisht e mundur të përcaktohet dëmi ekonomik).

Përfundimi i procedurave të prokurimit me një pjesëmarrës jo vetëm që ka ulur ndjeshëm konkurrencën e pjesëmarrësve dhe për pasojë efektivitetin në përdorimin e fondeve publike, por ka çuar gradualisht në krijimin e monopoleve në tregun e prokurimeve publike për sektorë të ndryshëm dhe kryesisht në sektorët e ndjeshëm të shërbimit për qytetarin.

Për vitin 2021 shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave për subjektet e audituara, janë në vlerën 11 miliardë lekë. Sipas klasifikimit të fushave përkatëse rezulton se në pjesën më të madhe prej 69% i përkasin

sistemit tatimor, por nuk mungojnë dhe shkelje të tilla në administrimin e pronës publike, në urbanistikë etj.

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion, për vitin 2021 arrijnë në shumën prej 43,8 miliardë lekësh. Ato kanë rezultuar në fushën e pagave dhe shpërblimeve, për shpenzime operative, në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor. Bazuar në rezultatet e auditimeve konstatohet se kjo shkelje e disiplinës financiare është e përhapur kryesisht në procedurat e prokurimit dhe të zbatimit të kontratave (investime në vlerën prej 24,5 miliardë lekësh) dhe në fushën të tjera (16.4 miliardë lekë).

KLSH-ja ka kërkuar përmirësime ligjore duke iu drejtuar legjislativit (Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit të Ekonomisë dhe atij të Ligjeve), për vendosjen e kushtit ligjor për numrin minimal të dy operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të kualifikuar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, gjë që jo vetëm do të ngushtojë hapësirat e autoriteteve kontraktore në përcaktimin e kritereve të veçanta subjektive për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë, me qëllim përfitimet e paligjshme dhe korruptive, por edhe do të rrisë konkurrencën dhe përdorimin me efektivitet të fondeve.

Gjatë vitit 2021 KLSH-ja ka evidentuar se ekzistojnë risqe të mundshme që kërcënojnë financat publike dhe që ndikohen nga vendimmarrjet e çështjeve gjyqësore nga gjykatat ndërkombëtare, ato të lidhura me kontratat koncesionare apo efektet e partneritetit publik-privat.

Duhet theksuar se nga auditimi i disa projekteve koncesionare/PPP në kuadër të implikimeve fiskale për buxhetin e shtetit mbi përballueshmërinë, qendrueshmërinë, fizibilitetin fiskal dhe risqet e marra përsipër nga sektori publik, bazuar kjo edhe në ndjeshmërinë e rritur të opinionit publik, janë identifikuar anomali dhe shkelje të cilat KLSH-ja i ka bërë prezente gjatë raportimit të zbatimit të buxhetit në Kuvend, duke propozuar dhe rekomandime dhe masa për përmirësimin e situatës.

Lidhur me rekomandimet dhe masat e propozuara, gjatë vitit 2021 janë rekomanduar 90 rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, 3074 rekomandime me karakter organizativ, si dhe 1088 rekomandime disiplinore dhe administrative. Këto rekomandime prekin përmirësime për amendime në kuadrin ligjor, raportimin financiar, por edhe përmirësime të kuadrit rregullativ të institucioneve me synim forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike. Në varësi të natyrës dhe impaktit të gjetjeve të auditimit, kur janë vlerësuar elemente të veprës penale,



janë kryer kallëzime në prokurori. KLSH-ja për vitin 2021 ka përcjellë 14 kallëzime penale për 62 persona duke pasur në qendër të vëmendjes luftën ndaj korrupsionit dhe të mashtrimit financiar, në të gjitha nivelet e qeverisjes, në përdorimin e fondeve dhe të pasurisë publike, duke synuar rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publikë, si dhe të efekteve parandaluese nëpërmjet ndëshkimit të personave të cilët janë vlerësuar se gjatë veprimtarisë tyre kanë kryer elemente të veprës penale.

Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodin e Punës, KLSH-ja u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 1088 masave disiplinore dhe administrative.

Nga 3074 masat organizative të rekomanduara, rezulton se afërsisht 50-60% e masave janë pranuar dhe janë zbatuar ose janë në proces zbatimi. Për sa i përket nivelit të zbatimit të rekomandimeve për auditimet e kryera gjatë vitit 2021, kjo do të verifikohet në auditimet për zbatimin e rekomandimeve.

Megjithatë, konstatohet se pavarësisht insistimit të vazhdueshëm të KLSH-së, për zbatimin në kohë të masave të rekomanduara si nëpërmjet auditimeve të veçanta, ashtu edhe atyre të radhës, përgjegjshmëria e menaxherëve dhe zyrtarëve të lartë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit vijon të mbetet ende e ulët.

Krahas aktivitetit bazë të auditimit, në përputhje edhe me objektivat strategjike institucionale, KLSH-ja ka zhvilluar me përparësi edhe komunikimin dhe bashkëpunimin me palët e jashtme të interesit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, i vetëdijshëm për rolin vendimtar që luan për informimin e Kuvendit të Shqipërisë, duke e konsideruar atë si partnerin kryesor, gjatë vitit 2021, ka përcjellë jo vetëm raportet e performancës institucionale dhe të zbatimit të buxhetit të shtetit si detyrim kushtetues, të cilat kanë ofruar informacion të detajuar mbi përdorimin e parasë publike si nga institucionet e qeverisjes qendrore, ashtu edhe atyre të vetëqeverisjes vendore, por edhe nëpërmjet përcjelljes së raporteve të veçanta të auditimit. Kështu, përgjatë vitit 2021 janë përcjellë 57 raporte të tilla për auditimet e kryera.

Gjithashtu, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve”, KLSH-ja edhe gjatë vitit 2021 ka informuar Kuvendin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna institucioneve të audituara, respektivisht nëpërmjet raportit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e kryera për periudhën janar-qershor 2020 dhe raportin për zbatimin e rekomandimeve të kryera për periudhën korrik-dhjetor 2020. Këto raporte i janë përcjellë edhe ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Ky raportim është shoqëruar edhe me përditësimin e platformës elektronike të Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë dhe statusin e implementimit të tyre. Në këtë platformë për vitin 2021 gjendet informacion për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në 12 subjekte.

Një tjetër mjet informimi për Kuvendin ka qenë edhe nëpërmjet përcjelljes së dy buletineve statistikore.

Nëpërmjet “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2020” miratuar në datën 24.06.2021, Kuvendi i ka kërkuar KLSH-së që në vitin 2021-2022 të vijojë punën në disa drejtime.

Me synim evidentimin e progresit të KLSH-së për implementimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, KLSH-ja ka miratuar Planin e Veprimit nr. 755/1, datë 01.09.2021, në të cilin janë përcaktuar qartazi 20 masa që do të ndërmerren, strukturat përkatëse për zbatimin e rekomandimeve specifike, afatet dhe treguesit e rezultateve si:

Rritja e numrit të auditimeve financiare, përmirësimi i cilësisë së tyre me opinione profesionale në plotësim të kërkesave të progresraportit të Komisionit Evropian;

krijimi i një qasjeje të auditimeve të performancës drejt fushave me ndjeshmëri publike, duke synuar që rezultatet e auditimit të 3 E-ve të kenë ndikim direkt në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe në menaxhimin e shëndoshë të financave publike;

evidentimin e fushave të pambuluara me auditim nga KLSH-ja në vite, si dhe planifikimin e veprimtarisë audituese të tyre për një qasje të pakufizuar dhe të pavarur në auditimin e institucioneve, organizatave që janë përdorues të fondeve publike;

aplikimin e praktikave më të mira të auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t, përditësimin me informacion të subjekteve të audituara dhe projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike, duke mbajtur në konsideratë raportin kosto/përfitim dhe sigurinë e sistemeve;

përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë audituese për ta zhvilluar atë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit,

angazhimin e KLSH-së për hartimin e një memorandumi mirëkuptimi me Kuvendin, me qëllim referimin e gjetjeve të auditimit në funksion të kontrollit parlamentar dhe rritjes së llogaridhënies publike, në zbatim të rekomandimeve të progresraportit të Komisionit Evropian;

rritjen e transparencës duke mundësuar zhvillimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ku të publikohen vendimet dhe raportet e plota të auditimeve, sipas afateve të përcaktuara në ligj dhe të rekomanduara nga Komisioni

European.

KLSH-ja, përmes komunikimit të vazhdueshëm me parlamentin, mediet, qytetarët dhe shoqërinë civile, është angazhuar për rritjen e transparencës, një tregues që ka ardhur në rritje nga viti në vit duke ndjekur në vijimësi një politikë e hapur dhe bashkëpunuese me medien, por edhe me qytetarët përmes ankesave drejtuar institucionit, për të garantuar një institucion të pavarur dhe të besueshëm.

Gjatë vitit 2021 vetëm në shtypin e shkruar janë publikuar 262 artikuj për aktivitetin auditues të KLSH-së, dhe në 400 artikuj në medien sociale dhe kronika televizive, të cilat i referohen kryesisht raporteve përfundimtare të auditimit, të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, si dhe njoftimeve për shtyp mbi auditimet e kryera. Ndër raportet e auditimit, të ndjekura dhe të raportuara me më shumë interes nga media kanë qenë auditimet të cilat kanë pasur në fokus edhe çështje sensitive për përdorimin e fondeve publike dhe shëndetin apo mirëqenien e qytetarëve. Gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara nga KLSH-ja përmes raporteve të auditimit janë ndjekur nga media edhe përmes materialeve më të zgjeruara televizive, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e profilit publik të veprimtarisë së institucionit.

Në kuadër të së drejtës për informim, përcaktuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në adresën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit gjatë vitit 2021 kanë ardhur 38 kërkesa për informacion, nga të cilat 35 kanë qenë në kompetencë të KLSH-së dhe u është dhënë përgjigje brenda afateve ligjore, ndërsa 3 prej tyre kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Kërkesat për informacion kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH-ja.

KLSH-ja gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2021 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit, duke i orientuar tek institucioni kompetent që ata duhet të drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.

Përgjatë kësaj periudhe KLSH-ja ka trajtuar 399 letra dhe ankesa, nga të cilat 117 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 282 ankesa në kompetencë të KLSH-së, 273 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 9 janë në proces verifikimi.

Ndërkohë, në përmbushje të objektivave të strategjisë së zhvillimit 2018-2022 KLSH-ja ka vlerësuar dhe ka vijuar zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përmendim këtu bashkëpunimin me prezencën e OSBE-së në Shqipëri, e cila do të jetë partnere me Autoritetin Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit (ANAC) për të forcuar nëpërmjet trajnimeve, kapacitetet profesionale të KLSH-së në kryerjen e auditimeve me fokus prokurimin publik dhe rritjen e cilësisë së tyre, aktivitet ky tashmë i filluar në nëntor të vitit 2021.

Partneriteti publik-privat është objekt i marrëveshjes së nënshkruar nga KLSH-ja me Ambasadën Zvicerane për financimin nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës (SECO) të projektit “Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri”. KLSH-ja është aktualisht në procesin e tenderimit të ekspertëve, të cilët do të trajtojnë audituesit e KLSH-së për kornizën ligjore të partneritetit publik-privat (PPP), do të hartojnë udhëzues specifik për auditimin e kontratave koncesionare dhe PPP-të, si dhe do të asistojnë audituesit në auditime specifike që fokusohen në këto çështje.

Gjithashtu KLSH-ja ka marrë angazhimin të jetë pjesë në iniciativën e IDI-t (njësia për zhvillim e INTOSAI-t) për asistencë në hartimin e dokumentit “Strategjia, matja e performancës dhe raportimi (SPMR)”, në të cilën KLSH-ja e mbështetur nga IDI përmes trajnimeve dhe asistencës do të kryejë vetëvlerësimin e performancës së institucionit duke përdorur metodologjinë e kornizës së matjes së performancës së INTOSAI-t, si dhe hartimin e strategjisë së re të zhvillimit të institucionit dhe monitorimin e saj.

KLSH-ja duke e konsideruar SIGMA-n si një nga partnerët më të rëndësishëm, e cila ka dhënë kontribut të qenësishëm në ngritjen e kapaciteteve të stafit, ka dakordësuar asistencën e saj për hartimin e strategjisë së komunikimit 2022-2025 dhe hartimin e Manualit të Auditimit të Buxhetit.

Sa u takon bashkëpunimeve me institucionet audituese ndërkombëtare, prej shtatorit 2021 KLSH-ja ka dakordësuar bashkëpunimin me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë, e cila do të trajtojë dhe asistojë audituesit e KLSH-së në fushën e auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe atyre të mjedisit.

Në kuadër të mbështetjes që Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë i jep rrjetit të SAI-ve të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE, krahas trajnimit për auditimet e performancës, të zhvilluar në 6 blloqe gjatë vitit 2021, KLSH-ja nën mbikëqyrjen e ekspertëve suedezë, po kryen auditimin e performancës me temë “Të drejtat e pasagjerëve në transportin ajror”, i cili është evaduar.

Besimi i Kuvendit, publikut dhe i të gjitha palëve të interesit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është i lidhur pazgjidhshmërisht me dy faktorë mjaft të rëndësishëm që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimeve profesionale, objektive dhe të paanshme që bazohen në metodologji, të cilat garantojnë zbatimin praktik të standardeve ndërkombëtare të auditimit publik dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit.

SIGMA në raportin e vlerësimit “Principet e administratës publike”, për KLSH-në nënvizon se: “Kuadri ligjor dhe nënligjor është i përafuar ngushtë me standardet ndërkombëtare dhe vazhdon të zbatohet dhe respektohet në praktikë”.

Megjithatë, me synimin e përafritit të kuadrit metodologjik me zhvillimet e reja që kanë pësuar standardet ndërkombëtare të auditimit, gjatë vitit 2021 KLSH-ja rishikoi dhe miratoi Manualin e Auditimit të Performancës. KLSH-ja gjithashtu po vijon punën për rishikimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit, si dhe hartimin e Manualit të Auditimit të Buxhetit.

Gjatë vitit 2021 veprimtaria e KLSH-së ka qenë objekt i vlerësimit të disa institucioneve ndërkombëtare, të cilat monitorojnë ecurinë e reformave në kuadër të procesit të integritetit europian dhe angazhimeve të qeverisë shqiptare për menaxhimin efektiv të financave publike.

Në datën 19 tetor 2021 Komisioni Europian ka publikuar progresraportin e vitit 2021 për Shqipërinë dhe në vlerësimet për kapitullin 32 “Kontrolli financiar” ku nënvizon se: “Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vitet e fundit, KLSH-ja ka marrë masa për zhvillimin profesional të stafit auditues. KLSH-ja ka vijuar të rrisë ndërgjegjësimin e botës akademike dhe shoqërisë civile mbi rëndësinë e auditimit të jashtëm. Ndikimi i punës audituese ka treguar njëfarë përparimi”.

Në raport theksohet se: “Cilësia e punës audituese duhet të përmirësohet për të qenë plotësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe se pavarësisht shkallës së lartë të rekomandimeve të pranuar nga institucionet, shkalla e zbatimit të plotë të rekomandimeve duhet të përmirësohet”.

Lidhur me rekomandimet e këtij progresraporti, KLSH-ja ka miratuar planin e veprimit nr. 1243, datë 12.11.2021, në të cilin janë përcaktuar 9 masa për implementimin e tri rekomandimeve, strukturat përgjegjëse, afatet kohore dhe indikatorët përkatës.

Gjatë vitit 2021 SIGMA kreu procesin e vlerësimit për parimet e administratës publike në Shqipëri. Pjesë e këtij vlerësimi ishte edhe veprimtaria e auditimit të jashtëm dhe në raportin e publikuar në dhjetor të vitit 2021, KLSH-ja është vlerësuar pozitivisht për:

Mënyrën e raportimit dhe shqyrtimit transparent të zbatimit të buxhetit;

sigurimin e pavarësisë, mandatit dhe organizimit të institucionit suprem të auditimit, nga kuadri kushtetues dhe ligjor dhe respektimi në praktikë;

zbatimin nga KLSH-ja të standardeve në mënyrë neutrale dhe objektive për të siguruar auditime me cilësi të lartë, të cilat ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.

Në përfundim, i nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të Komisionit, dëshiroj të theksoj se gjatë vitit 2021 KLSH-ja ka përmbushur përgjegjësitë e veta kushtetuese, detyrimin ligjor, si dhe ka përmbushur misionin auditues, duke treguar për një aktivitet që reflekton integritet dhe paanshmëri, në pajtueshmëri me standardet e praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit. Objektiviteti, integriteti, përgjegjshmëri, profesionalizimi, bashkëpunimi dhe transparenca, besoj se kanë qenë pjesë e punës së institucionit tonë.

Faleminderit për vëmendjen!

**Eduard Shalsi** – Duke të të falënderuar, dua t'ua jap fjalën relatove, duke filluar me zonjën Koliqi dhe duke vijuar me zonjën Zake!

**Enslëmvera Zake** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe kryetarit të KLSH-së...

**Eduard Shalsi** – Thashë që do të fillojmë me zonjën Koliqi, për forcë zakoni. Më the që kësaj here ta bëjmë pak më ndryshe. Kështu që...

**Emilja Koliqi** – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit për paraqitjen e raportit...

*(Zonja Emilja Koliqi flet pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Të lutem, ndize pak mikrofonin!

**Emilja Koliqi** – Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për periudhën janar-dhjetor 2021 ka realizuar veprimtarinë audituese, duke realizuar dhe evaduar 158 misione auditimi në 205 subjekte auditimi.

Rezultatet e veprimtarisë audituese të vitit 2021, krahas masave organizative për përmirësimin e situatës, kanë pasur objektiv edhe identifikimin e shkeljeve dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik, që i referohet detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti, që i shkaktohet entit shtetëror të audituar, në lidhje me veprime ose mosveprime, si parregullsi, paligjshmëri, me efekte negative në financat publike nga aktiviteti i subjekteve në auditim.

Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara i referohen përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në fushën e prokurimit publik, për shkak të mungesës së kontrollit në realizimin e këtyre procedurave, të cilat në shumë raste rezultojnë të kryera jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; shkeljeve të disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike; likuidimit të faturave për shpenzime, investime, që është shoqëruar me krijimin e detyrimeve të prapambetura; parregullsive dhe shkeljeve në administrimin e të ardhurave tatimore dhe jotatimore; keqadministrimit të pronës shtetërore.

Nga analiza e parregullsive dhe shkeljeve financiare sipas fushave, dëmi ekonomik në total është rreth 19,1 miliardë, ku në fushën e të ardhurave 17,4 miliardë dhe në fushën e shpenzimeve 1,7 miliardë.

Përveç dëmit ekonomik, reflektohen dhe efekte negative për shkak të parregullsive. Në fakt, vlera këtu është shumë e konsiderueshme, me një total prej 55,4 miliardë, ku të ardhura janë 10,9 miliardë dhe në fushën e shpenzimeve 44,4 miliardë, por ne jemi të paqartë ose nuk jemi njohur në raport me metodologjinë që përdoret nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vlerësimin e efekteve negative për shkak të parregullsive.

Në kuadër të angazhimit për të luftuar pa kompromis veprimet abuzive dhe të mashtrimit financiar me pronën publike, me synim përmirësimin e qeverisjes publike edhe gjatë vitit 2021, KLSH-ja ka përcjellë në organet kompetente 14 kallëzime dhe indicie penale, 6 prej tyre në SPAK dhe 8 të tjera pranë prokurorive të rretheve gjyqësore për 62 zyrtarë të niveleve të ndryshme, por nuk vihemi në dijeni nëpërmjet kontrollit se si është ecuria e këtyre kallëzimeve.

Në rezultatet e auditimeve janë dhënë disa opinione auditimi: opinion i pakualifikuar, kur arrihet në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; opinion i kualifikuar, kur arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; opinion i kundërt, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se

anomalitë janë materiale individualisht ose së bashku dhe janë të përhapura në llogaritë vjetore apo transaksionet.

Gjatë auditimit të buxhetit të shtetit për vitin 2021, nga analizat që janë bërë sipas departamenteve të ndryshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë vitit 2021 janë realizuar 22 auditime. Në auditimet e evaduara të vitit 2021, 17 prej tyre kanë qenë auditime përputhshmërie, 3 auditime të kombinuara përputhshmërie, si dhe auditime tematike.

Në vlerësim të situatës, materialitetit, përhapjes së parregullsive dhe impaktit të tyre në miradministrimin e financave publike, nga 22 auditime të kryera janë dhënë opinione për 19 prej tyre, 1 opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes, 9 opinione të kualifikuara dhe 9 opinione të kundërta.

Treguesi i lartë i opinioneve të kundërta, në masën 47%, tregon se në numër të konsiderueshëm subjektet e audituara kanë shfaqur mangësi të theksuar në menaxhimin ekonomik dhe financiar të veprimtarisë së tyre, me pasoja në frenimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Nga auditimi i njësive të qeverisjes vendore, gjatë vitit 2021 janë realizuar 46 dhe janë në proces evadimi 7 subjekte. Në auditimet e evaduara të vitit 2021, 34 prej tyre kanë qenë auditime të kombinuara, financiare dhe përputhshmërie, 9 auditime tematike për pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2 auditime tematike për koncesionet PPP, shkollat në Tiranë dhe në Thumanë, si dhe 1 auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve. Në vlerësim të situatës, janë dhënë opinione për 33 prej tyre, nga 46 auditime të kryera, 7 opinione të pakualifikuara auditimi, me theksim çështjeje, 16 opinione auditimi të modifikuara me rezervë dhe 10 opinione të kualifikuara, opinione të kundërta.

Treguesi i lartë i opinioneve të kualifikuara, në masën 80%, tregon se në numër të konsiderueshëm subjektet e audituara kanë shfaqur mangësi të theksuara në menaxhimin ekonomik dhe financiar të veprimtarisë së tyre, me pasoja në frenimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Në lidhje me bashkëpunimin e KLSH-së me institucionet e tjera, që monitorojnë ecurinë e reformave në Shqipëri, në raport janë paraqitur bashkëpunimet me OJF-të. KLSH-ja ka vijuar dhe pas përfundimit të punës audituese, duke vlerësuar se ato mund të ndikojnë ndjeshëm që mesazhet dhe rekomandimet e KLSH-së të jenë gjerësisht të njohura.

#### Bashkëpunimi i KLSH-së me UN Women

KLSH-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me UN Women, nëpërmjet së cilës angazhohen për avancimin e zbatimit të angazhimeve për barazinë gjinore dhe monitorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.



Raporti i monitorimit për Shqipërinë i OECD-së, publikuar në nëntor 2021

Shqipëria paraqet një bazë solide për menaxhimin e financave publike, përmirësime në legjislacionin e prokurimit publik, por dobësi të vazhdueshme në kontrollin e brendshëm dhe auditimin. Në përgjithësi, performanca fiskale në Shqipëri ka qenë e qëndrueshme dhe procesi e planifikimi buxhetor është plotësisht i vendosur, por ai mund të përmirësohet më tej, duke forcuar stabilitetin e tavaneve sektoriale në periudhën afatmesme.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka përditësuar metodologjitë e tij të auditimit dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, por mbetet ende punë për të bërë për të përmirësuar zbatimin dhe cilësinë e auditimit.

Për sa i përket funksionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si organ mbikëqyrës i jashtëm për funksionimin e sistemit të MFP-së, që nga viti 2017 nuk janë zbatuar ndryshime të rëndësishme në kuadrin kushtetues dhe ligjor.

KLSH-ja i ka përditësuar të gjitha metodologjitë e auditimit dhe procedurat e sigurimit të cilësisë, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, mbetet shumë punë për të bërë për t'i futur këto metodologji në praktikën e punës dhe për të përmirësuar cilësinë e auditimit.

Disa rekomandime afatshkurtra që paraqiten në raportin e OECD-së.

MFE-ja duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të reduktuar stokun e detyrimeve të prapambetura në shpenzime. Ajo duhet të përdorë auditimet e KLSH-së për të analizuar sytë e paplotësueshmerisë aktuale të të dhënave. KLSH-ja duhet të bazohet në Memorandumin e Mirëkuptimit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit dhe të rrisë angazhimin me parlamentin për të shpjeguar përfitimet e punës së tij.

Gjithashtu, në rekomandimet afatmesme thuhet se parlamenti duhet të marrë një rol më aktiv në ciklin buxhetor, veçanërisht në lidhje me PBA-në dhe raportimet e auditimit të KLSH-së.

Në lidhje me ...

A mund të bëjmë pyetje më vonë?

**Eduard Shalsi** – Një sekondë.

Si do ta bëjmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi, të lutem!?

Zonja Koliqi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë, zonjë.

Do t'i japim mundësi relatores po me të njëjtin minutazh të lexojë edhe ajo relacionin e saj dhe më pas do të fillojmë me zonzjën Zake dhe me zonzjën Koliqi. Pastaj, për cilindo që ka pyetje, dhe unë jam i bindur se ka shumë pyetje për t'u bërë, do të kalojmë te pyetjet.

Dakord?

Faleminderit, zonja Koliqi!

Po, zonja Zake.

**Enslemvera Zake** - Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti kryetar i KLSH-së për prezantimin!

Falenderime kam edhe për kolegen dhe për shërbimet e Kuvendit, me të cilët ne kemi punuar në mënyrë periodike mbi raportin e KLSH-së! Patjetër, raporti, që do të vijë edhe në formën e një rezolute, ka gjetur një konsensus nga të dyja palët.

Unë nuk do të ndalem në ato që tha kolegia, por do të fokusohem në disa nga çështjet e tjera dhe më pas te rekomandimet dhe problematikat, për një pjesë të të cilave kam edhe disa pyetje, të cilat ju mund t'i mbani shënim dhe në fund të përgjigjeni, nëse do ta vlerësoni.

Lidhur me strukturën organizative të KLSH-së, organika e saj është e përbërë nga 218 punonjës, nga 203 punonjës që ka pasur në vitin 2020 dhe 219 punonjës që ka pasur në vitin 2019.

Gjatë vitit 2021 janë kryer shumë procedura rekrutimi sipas dispozitave ligjore për nëpunësit e administratës së KLSH-së: janë zhvilluar 9 procedura të miratuara dhe janë ngritur në detyrë një kategori prej 15 audituesish. Megjithatë, në raport nuk janë dhënë të sakta rastet dhe arsyet e largimit nga puna të punonjësve për vitin e kaluar, si dhe proceset gjyqësore në të cilat KLSH-ja është paditur për këtë qëllim.

Buxheti i institucionit të KLSH-së, pas ndryshimit me aktin normativ të datës 3 dhjetor 2021, është në vlerën 391 083 000 lekë. Në fund të vitit 2021 buxheti rezulton të jetë realizuar në masën 89,2%, ku mosrealizimi ka qenë në fushën e investimeve me financim të huaj me 0%, investimet me financim të brendshëm 37,9% dhe transferta korrente tek të huaj në masën 40,7%.

Lidhur me misionin e auditimit të brendshëm të këtij institucioni, janë dhënë gjithsej 15 rekomandime nga strukturat audituese, janë pranuar plotësisht 12 rekomandime dhe pjesërisht 1 rekomandim dhe janë refuzuar 2 rekomandime, megjithatë mungon një informacion se cilat janë rekomandimet e dhëna dhe në veçanti ato që janë refuzuar.

Gjithashtu, konstatohet se për raportet e auditimit të përgatitura nga strukturat e auditimit të brendshëm në KLSH informacioni është pasqyruar jo i plotë. Kështu që, për një monitorim sa më efikas të institucionit sugjerohet që në vitet në vijim raportet e auditimit të

brendshëm të dorëzohen të plota dhe t'i bashkëlidhen raportit të performancës, në mënyrë të tillë që të sigurohet një informacion më i saktë në këto raporte.

Lidhur me implementimin e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të datës 24 qershor 2021, është kryer me rigorozitet nga strukturat përkatëse për ndërmarrjen e masave konkrete të parashikuara nga planin e veprimit nr. 755/1 të datës 1 shtator 2021, që i referohet faqeve 158-160 të raportit vjetor. Siç e tha edhe kolegia, në vitin 2021 KLSH-ja ka rritur ndjeshëm numrin e auditimeve financiare, krahasuar me ato të vitit 2020, me 5 auditime financiare dhe 16 auditime të përputhshmërisë. Gjatë vitit 2021 janë kryer 21 auditime financiare dhe 41 auditime të kombinuara, pra, financiare dhe të përputhshmërisë, në të cilat kanë dhënë opinion edhe për pasqyrat financiare.

Lidhur me databazën e subjekteve sipas përcaktimeve ligjore për auditimin e IT-së nga ana e KLSH-së, është vlerësuar risku paraprak për 267 subjekte, nga të cilat 36 subjekte ose 30% u vlerësuan me risk të lartë, ndërsa deri në fund të vitit 2021 rezulton të jenë audituar 15% e listës së këtyre subjekteve.

Departamenti i Auditimit të Performancës është në proces të hartimit të një dokumenti specifik në të cilin do të evidentohen fushat, të cilat paraqesin risk për financat publike. Gjatë vitit 2021 përqindja e auditimit të performancës në raport me totalin e auditimeve të planifikuara nga KLSH-ja është rreth 13,3%. Gjatë sesionit të trajnimit lidhur me këtë manual janë trajnuar rreth 30 auditues. Pyetja ime është: Kur parashikohet të jetë gati ky dokument?

**Eduard Shalsi** – Mbarove? Do të kalojmë te pyetjet?

**Enslemvera Zake** – Jo, po bëj konstatime, por njëkohësisht edhe pyetje.

**Eduard Shalsi** – Do të doja të përfundonim konstatimet dhe pastaj të fillonim me pyetjet.

**Enslemvera Zake** – Nuk kam shumë pyetje.

**Eduard Shalsi** - Aq sa kenë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rregull. E bëra për të fituar kohë, që të mos u rikthehem edhe njëherë konstatimeve kur të bëjë pyetjet, por, gjithsesi, po i lë për në fund.

Në faqen zyrtare të internetit të KLSH-së rezulton se gjatë vitit 2021 janë publikuar rreth 100 raporte të auditimeve të evaduara gjatë vitit 2021, 61 njoftime për shtyp, nga të cilat 12 njoftime janë informuar për publikun dhe janë bërë kallëzime penale nga KLSH-ja, i janë përcjellë SPAK-ut dhe prokurorisë për shkeljet konkrete, të cilat lidhen me shpërdorimin e detyrës, shkeljen e barazisë në tenderë dhe të tjera.

Gjatë monitorimit efektiv dhe në kohë të zbatimit të rekomandimeve të auditimit, është përmirësuar ndjeshëm puna gjatë vitit 2021. Në vitin 2020 KLSH-ja raportoi se 70% e rekomandimeve të saj janë në proces zbatimi dhe disa prej tyre janë zbatuar plotësisht. Pavarësisht nga një shkallë e lartë e rekomandimeve të pranuar nga institucionet, shkalla e rekomandimeve të zbatuara plotësisht duhet që të përmirësohet.

Platforma elektronike për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit është funksionale që nga viti 2019 dhe në qershor të vitit 2020 është miratuar edhe manuali përkatës.

Nga ana e auditimit të jashtëm, pavarësia e mandatit dhe organizimi i institucioneve supreme të auditimit mbrohen me kuadër kushtetues dhe ligjor dhe respektohen në bazë të praktikave më të mira. Pavarësia e institucionit suprem të audituar është vlerësuar me pikëzimin 4, kurse performanca e përgjithshme e KLSH-së për vitin 2021 është vlerësuar me 3. Për këtë kam një pyetje, të cilën nuk po e bëj tani.

Megjithatë, perceptimi nga publiku për pavarësinë e KLSH-së është relativisht i ulët, në masën 39% për vitin 2020, por kjo paraqitet me një përmirësim të ndjeshëm duke e krahasuar me vlerësimin e fundit të vitit 2017, kur ishte në shifrat 26%. Ky trend pozitiv reflektohet edhe nga një tjetër anketë që është bërë dhe tregon që popullata shqiptare e konsideron KLSH-në mekanizmin më efektiv të llogaridhënies.

Procedurat e rishikuara për kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare u prezantuan fillimisht në vitin 2019. Mbledhjet e fundit për sigurimin e cilësisë për auditimet e përfunduara gjatë vitit 2021 raportojnë progresin në përputhje me standardet ndërkombëtare nga 60% në 80%, megjithatë raporti i sigurimit të cilësisë tregon se çështjet e përgjithshme me përfshirjen e metodologjive të reja, si një dokumentacion që kërkon prioritizimin e rekomandimeve dhe hartimi i raporteve ka qenë i dobët dhe shihen edhe dobësi në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, kështu që kërkohet një vëmendje më të vazhdueshme në aspektin menaxherial të KLSH-së.

Nga rekomandimet e bëra gjatë vitit 2019, 80% prej tyre janë pranuar nga të audituarit, por vetëm 50% e atyre të pranuar janë zbatuar, kurse pjesa tjetër e raportuar është në proces.

Siç është raportuar në vlerësimin e vitit 2017, shumë nga këto rekomandime nuk kanë prioritet, mbeten të paqarta dhe janë me një rëndësi të vogël. Rrjedhimisht, ato nuk respektohen gjithmonë nga të audituarit. Raportet e auditimit të performancës së KLSH-së shënojnë një ndryshim të qartë që përmban rekomandime të argumentuara mirë për të paktën një numër auditimesh, të mbështetura qartë në provat e paraqitura nga ana e KLSH-së.

Lidhur me analizën e performancës së vitit 2021, duke konsideruar parametrat që ka përcaktuar në tabelë në raportin e saj KLSH-ja, duke përfshirë dëmin ekonomik, analiza e dëmit ekonomik dhe efektet negative në buxhet, siç e tha edhe kolegja, është e përcaktuar në vlerën 75 miliardë lekë, por nuk është e përcaktuar një metodologji e qartë se si është përlllogaritur kjo vlerë e dëmit ekonomik, në mënyrë që kjo të jetë e qartë edhe për institucionet që auditohen, për të përlllogaritur vlerën e dëmeve ekonomike apo efektet negative për shkak të parregullsive.

Gjatë raportit të performancës mungon informacioni për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e periudhës janar-qershor 2021.

Gjithashtu, nga të dhënat rezultojnë se KLSH-ja nuk ka bërë një analizë të detajuar për sa u takon arsyeve të refuzimit të rekomandimeve apo të vonësive në zbatimin e rekomandimeve të pranuar nga institucionet.

Nga të dhënat e buletinit të auditimeve rezultojnë se puna e audituesve është përmirësuar në tremujorin e tretë të vitit për periudhën korrik-shtator 2021. Referuar buletinit për periudhën janar-qershor të KLSH-së janë evaduar 27 auditime, ndërsa për periudhën korrik-shtator janë evaduar 80 auditime ose më shumë se gjysma e auditimeve të evaduara përgjatë gjithë vitit 2021.

I njëjti trend rritës evidentohet edhe te rekomandimet.

Kështu, për auditimet e evaduara për periudhën janar-qershor 2021, KLSH-ja ka dhënë 631 rekomandime, ndërsa për periudhën korrik-shtator 2021 janë dhënë 2358 rekomandime.

Parregullsitë lidhur me shkeljet financiare në të ardhurat dhe shpenzimet janë konsideruar nga ana e KLSH-së në shumën totale 19,1 miliardë lekë, ndërsa parregullsitë lidhur me paligjshmëri të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara janë në vlerën 55,4 miliardë lekë.

Në raportin e performancës të paraqitur nga KLSH-ja ndër vite, për sa i takon përlllogaritjes së dëmit ekonomik, nuk është përcaktuar qartë metodologjia. Për këtë qëllim lihet vend për dyshime në përlllogaritjen e kësaj vlere të dëmit ekonomik.

Gjatë vitit 2021 KLSH-ja është angazhuar në 111 procese gjyqësore, nga të cilat 12 të tilla janë të karakterit penal, 98 janë të procesit administrativ dhe/ose civil, dhe 1 proces është në Gjykatën Kushtetuese. Edhe për këtë pjesë informacioni i paraqitur nga KLSH-ja nuk është i plotë. Pra, nuk arrihet të kuptohet se sa është numri i çështjeve penale për të cilat ka përfunduar procesi gjyqësor, sa çështje kanë kaluar për shqyrtim në vitin në vijim, sa janë vendimet gjyqësore në favor të KLSH-së, për sa çështje të tjera është pranuar pushimi i

procedurave penale dhe për sa çështje të tjera KLSH-ja ka depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me problematikat e dala gjatë monitorimit vjetor dhe atij periodik, nuk ka ende një analizë për evidentimin e fushave të pambuluara nga auditimi i KLSH-së ndër vite. Nuk është vepruar sa duhet për një qasje të auditimeve të performancës drejt fushave me ndjeshmëri publike. Numri i auditimeve të IT-së është i papërfillshëm referuar standardeve të kërkuara. Nga 158 auditime të evaduara, në faqen e institucionit janë publikuar vetëm 91 të tillë dhe i janë përcjellë Kuvendit vetëm 58 raporte. Pra, pak më shumë se një e treta e të gjitha raporteve të vitit 2021.

Raporti i sigurimit të cilësisë, siç e thashë, tregon se duhet të vendosen prioritete dhe këto në përmirësimin e raporteve, në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, që kërkon një vëmendje menaxheriale nga ana e KLSH-së.

Mund të ndalem te disa prej rekomandimeve, të cilat do të jenë edhe pjesë e rezolutës?

*(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon):* Do t'i bëjmë veç ato...

**Enslemvera Zake** – Në rregull.

Mund të kaloj te pyetjet apo të vazhdojë zonja Koliqi?

**Eduard Shalsi** – Atëherë, meqenëse e keni fjalën, vazhdoni me pyetjet tuaja dhe pastaj do ta marrë fjalën zonja Koliqi.

**Enslemvera Zake** – Në rregull.

**Eduard Shalsi** – Jemi te pjesa e pyetjeve. Do të qëndrojmë te pyetjet dhe pastaj do të kalojmë te diskutimet.

Po i mbaj shënim. Zonja Dhima, e ngritët dorën?

*(Diskutime në sallë)*

**Enslemvera Zake** – Departamenti i Auditimit të Performancës është në procesin e hartimit të një dokumenti specifik, ku do të evidentohen fushat që paraqesin risk për financat publike. Shtroj pyetjet: kur parashikohet të jetë gati ky dokument dhe cilat janë fushat që paraqesin risk më të lartë për financat publike sipas të dhënave që dispononi ju deri tani?

**Eduard Shalsi** – Do të doja që kur t'u përgjigjeni, t'i referoheni pyetjes konkrete dhe emrit të deputetit. Unë lexoj emrat e deputetëve dhe, kur t'u përgjigjeni pyetjeve, referojuni: pyetja një, pyetja dy e me radhë.

**Enslemvera Zake** – Duke qenë se në raportin tuaj për evidentimin e fushave të pambuluara me auditim nga KLSH-ja në vite keni sqaruar se kjo e fundit për vitin 2022 do të realizojë një temë auditimi, që do të fokusohet tek auditimi i implementimit të objektivave të

zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së, shtrohet pyetja: cilat janë veprimtaritë e ndërmarra për vitin 2021 lidhur me këtë rekomandim?

Nga Departamenti i Auditimit të IT-së është hartuar një bazë të dhënash e subjekteve që, sipas përcaktimeve ligjore për auditimin e IT-së, janë 267 subjekte për të cilat është vlerësuar risku paraprak për subjektet, nga të cilat 36 subjekte ose 13% janë vlerësuar me një risk të lartë. Nga ky departament është hartuar informacioni mbi mbulimin me auditimin e IT-së deri në datën 31.12.2021, nga ku rezulton se deri në fund të atij viti janë audituar 15% e listës së subjekteve.

Pyetja konsiston në lidhje me këtë pikë, pra 15% e subjekteve të audituara deri më 31.12.2021 është një vlerë e vogël, sa është përqindja e subjekteve të vlerësuara me risk të lartë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pyetja tjetër. Me vendim gjyqësor ju keni akses te sistemi i tatimeve. A ka ndikuar kjo në përmirësimin e punës suaj? A ka sjellë përmirësim të rekomandimeve drejt institucioneve që ju auditoni apo ka sjellë edhe të ardhura apo rritje të efekteve financiare në buxhetin e shtetit? Pra, qasja në aksesin e sistemit të tatimeve a ka sjellë përmirësime të punës suaj dhe në çfarë drejtimesh?

Gjithashtu, në raportin e performancës në faqen 170 jeni shprehur se “gjatë aktivitetit auditues këto dy vjetët e fundit janë evidentuar raste të reagimeve kundërshtuese apo pengesa në dhënien e plotë të informacionit të kërkuar”, duke kufizuar kështu audituesit në marrjen e sigurisë së arsyeshme për të mbështetur më pas opinionin në auditimin tuaj. Nga cilat institucione është evidentuar kjo rezistencë dhe a keni marrë masa në këtë drejtim?

Një pyetje tjetër është në lidhje me performancën e përgjithshme të KLSH-së, e cila për vitin 2021 është vlerësuar me “3”. A mund të na jepni më shumë sqarime në lidhje me aspektet që kërkojnë përmirësim dhe cilat janë veprimtaritë konkrete që do të ndërmerrni?

Gjatë auditimeve, në momentin që paraqisni në institucionet që auditoni projekt-raportin e auditimit më pas i lini institucionit një kohë për vëzhgimet e nevojshme. A i merrni parasysh vëzhgimet e subjekteve që auditoni në momentin e hartimit të raportit përfundimtar? A keni një bazë të dhënash se sa për qind e këtyre vëzhgimeve merren parasysh?

Gjithashtu, në raport keni paraqitur që keni bërë kallëzime penale ndaj subjekteve apo personave për të cilët ju keni evidentuar se kanë kryer shkelje gjatë ushtrimit të detyrave. A keni një informacion ose a e monitoroni procesin e kallëzimeve penale, apo ju keni detyrë vetëm për t’i bërë këto kallëzime penale dhe më pas çështjet penale qëndrojnë ose pushohen, ose më pas shkojnë deri në fund, por si pjesë e kallëzimit penal vlerësohet edhe dëmi

ekonomik? Në qoftë se kjo çështje penale pushohet, vlerësimi i dëmit ekonomik stornohet nga databaza që ju keni, apo qëndron atje dhe nuk keni një proces monitorimi të kallëzimeve penale apo të shpërdorimeve të detyrës, të cilat, sigurisht, kanë edhe efekte financiare?

Një tjetër pyetje është: gjatë vitit 2021, në përmbushje edhe të rezolutës, ju duhej të përcaktonit rekomandimet tuaja për rezolutën, por edhe rekomandimet ndaj të tjerëve, ndaj personave ose ndaj institucioneve që auditoni; a e keni sjellë draftin e rekomandimeve, të cilin e keni detyrim ta paraqisni?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Zake!

Zonja Koliqi e ka fjalën dhe sipas radhës, zoti Xhelil, zonja Tabaku, zoti Braçe, zonja Dhima, dhe pastaj zonja Denaj.

Zonja Koliqi, për pyetje.

**Emilia Koliqi** – Disa nga pyetjet u ezauruan nga zonja Zake, megjithatë unë i kam disa pyetje të tjera.

Në vlerësimin e progresraportit të Komisionit Europian për vitin 2021, ju keni raportuar se 75% e rekomandimeve janë në proces zbatimi dhe disa prej tyre janë zbatuar plotësisht. A mund të kemi shifra të sakta, si ka vazhduar ecuria e zbatimeve të rekomandimeve për vitin 2020? Në qoftë se keni të dhëna dua të di edhe ecurinë për vitin 2021.

Përsëri në kuadër të angazhimit për të luftuar veprimet abuzive dhe mashtrimet financiare me pronën publike, me synim përmirësimin e qeverisjes publike, ju në 10 vjetët e fundit 2012-2021 keni përcjellë 358 kallëzime penale për zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë, të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH-së. Referuar këtij numri, a keni një evidencë për ecurinë e prokurorisë për kallëzimet penale? Sa nga këto vendime janë ankimuar? Për sa prej tyre kanë përfunduar proceset penale? Sa prej tyre janë pushuar? Çfarë është bërë me to, nëse janë pranuar nga gjykatat dhe sa janë rrëzuar nga gjykatat? Pra, a ka një evidencë të plotë për sa u përket kallëzimeve penale për këtë 10-vjeçar?

Në vijim të marrjes përsipër nga ana juaj të auditimit të jashtëm për njësitë e qeverisjes vendore, referuar nenit 50 të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore, ku përcaktohet se veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohet çdo vit auditimit të jashtëm, sa po e realizoni detyrën që keni marrë përsipër për mbulimin me auditim të të gjitha njësive të qeverisjes vendore? Gjatë vitit 2021 keni realizuar 46 të tilla, si dhe janë në proces evadimi 7 subjekte, por ju kujtoj që janë 61 njësi të qeverisjes vendore, kështu që si do ta realizoni këtë auditim?



Nga viti në vit keni rritje të numrit të punonjësve dhe nga viti 2020 deri në vitin 2021 keni një rritje prej 15 punonjësish. Përsëri, edhe në vitin 2022 keni një rritje, duke e çuar numrin e punonjësve të KLSH-së në 233 punonjës. Në fakt, në vitin 2021 numri i saktë ka qenë 196, pra me një diferencë prej 22 punonjësish. Cilat janë arsye që ka një ulje të numrit të punonjësve, në një kohë kur ju keni kërkuar 15 punonjës të tjetër? Për më tepër, gjatë rishikimeve të buxhetit me akte normative, ju një herë keni kërkuar 4 milion rritje për fondin e pagave në muajin qershor, ndërsa në fund të vitit keni një pakësim gati me 20 milionë të fondit të pagave. A është kjo një mungesë planifikimi e saktë nga ana juaj?

Gjithashtu, në investimet kapitale, përveç asaj që ju keni realizuar, vetëm 38% janë me financim të brendshëm, nga 20 milionë që keni pasur të parashikuara. Do të ndalem pak tek investimet kapitale me financim të huaj, sepse është i rëndësishme projekti i përgatitur nga KLSH-ja, ku në vitin 2016 si pjesë e aplikimit për mbështetje nga INTOSAI, projekti do të mundësonte auditime më cilësore dhe rekomandime me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publikë përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Pse nuk është realizuar ky investim dhe cilat janë pengesat? Në të njëjtën kohë, a është përsëri efektiv fondi i parashikuar për këtë objekt edhe në vitin 2022?

Në lidhje me praktikën e bashkëpunimit me institucione të ndryshme, dua të di pak praktikën e bashkëpunimit me institucionet akademike. Me sa e kam ndjekur punën tuaj, të gjitha analizat e departamenteve ju i keni bërë nëpër universitete të ndryshme të vendit. Si e parashikoni ecurinë e bashkëpunimit të mëtejshëm me institucionet akademike, në funksion të rritjes edhe të besimit të publikut në rolin e institucionit të KLSH-së?

Në lidhje me auditimet e performancës, gjatë vitit 2021 keni realizuar 18 auditime performance. Dua të di si iniciohen këto auditime? Mbi çfarë baze iniciohen këto auditime performance, bëhen me propozime të ndonjë institucioni, mbi bazën e auditimeve të kryera nga ana juaj? Pra, si iniciohen dhe si është ecuria e tyre? Ku përcaktohen tematikat e auditimeve të performancës?

Për vitin 2021 ju thoni se gjatë periudhës janar-korrik keni evaduar 27 auditime, ndërsa për pjesën tjetër keni 80 auditime, pse ka një disbalancim kaq të madh, midis 6 ose 7 mujorit të parë dhe 5 muajt e tjerë keni bërë gati më shumë se dyfishin apo trefishin e punës?

Në lidhje me kallëzimet penale, si është praktika me institucionet homologe të huaja në lidhje me kallëzimet penale nga institucionet e larta publike, për ato insitucione që keni marrëdhënie? Njëkohësisht, në qoftë se institucionet publike kanë paqartësi për procedura të ndryshme, të cilat mund të quhen edhe “shkelje” në proceset e auditimit nga KLSH-ja, cila

është mënyra e komunikimit? A ka një komunikim direkt, një platformë ku mund të drejtohen pyetjet apo duhet bërë vetëm nëpërmjet shkresave? Nga këto komunikime, sa prej tyre kanë marrë përgjigje, në qoftë se ka pasur kërkesa të vazhdueshme?

Ju faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit zonja Koliqi!

Atëherë, meqenëse janë një bllok i madh pyetjesh, kalojmë te përgjigjet pastaj kalojmë te deputetët për pyetje të tjera. Në rregull?

**Arben Shehu** - Po.

Faleminderit, kryetar!

Nëse mundet do të filloj nga përgjigjja për pyetjen e përbashkët të dy deputeteve të nderuara, relatore në komision, në lidhje me monitorimin për ecurinë e kallëzimeve penale të drejtuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në fillimi dua të sqaroj se menjëherë pas kryerjes nga ana jonë e kallëzimeve penale, të rasteve kur është konstatuar shkelja e ligjit, pra konstatime të kryerjes së veprave penale, prokuroria kryen veprime institucionale të përcaktuara në Kodin e Proceduarve Penale dhe në ligjin organik të tyre. Normalisht, puna jonë monitoruese është e rëndësishme dhe përveç momentit të kryerjes së kallëzimet, ne jemi të detyruar t'i përgjigjemi në çdo moment, çdo lloj kërkesë nga ana e institucionit të organit të prokurorisë për vënie në dispozicion të materialeve shtesë, të sqarimeve shtesë, nëpërmjet akteve konkrete, nëpërmjet vënies në dispozicion të punonjësve, të cilët kanë kryer këto veprime, për të sqaruar se si nëpërmjet këtyre veprimeve kanë arritur në këto konstatime.

Dua të sqaroj se këto kallëzime nga ana jonë janë në proces nga ana e prokurorisë. Vëmendja jonë maksimale do të jetë në ato raste, kur do të kemi vendim për mosfillim shqyrtimi të çështjes apo pushimi shqyrtimi nga ana e prokurorisë, ku në bazë të ligjit jemi të detyruar të ankimojmë në gjykatë dhe ta ndjekim me kujdes të veçantë me profesionalizëm dhe në respektim maksimal të ligjit. Momentalisht, veprimet janë duke u kryer nga ana e prokurorisë dhe jemi në pritje të ecurisë së këtyre rasteve, pra kemi një vëmendje maksimale. Njëkohësisht, jemi në vëmendje maksimale për të rritur frymën e profesionalizmit edhe të përgjegjshmërisë nga ana e stafit tonë, në mënyrë që të jemi sa më të saktë në ato raste kur vlerësojmë se jemi përpara shkeljes së ligjit penal dhe përgjegjësisë penale të përfaqësuesve të subjekteve të audituara, pra për rritjen e nivelit profesional. Në vazhdimësi, nëse do të jetë e nevojshme, ne jemi të gatshëm që t'ju vëmë në dispozicion nëpërmjet statistikave përmbledhëse, apo ndoshta edhe me detajime për raste të veçanta për secilën nga kategoritë, të cilat do të shtrohen përpara nesh, qoftë për rastet që do të kenë ecuri nga ana e prokurorisë për kalim dhe gjykim, qoftë edhe për rastet kur do të kemi mosfillim, ose pushim të

procedimit penal. Nëse do ta vlerësoni se nevojiten, ne do të jemi të gatshëm në mënyrë të menjëhershme për t'ua vënë në dispozicion në mënyrë të arsyetuar.

Lidhur me pyetjen tjetër të zonjës Koliqi në lidhje me konstatimet nga ana e institucioneve për ankesat në lidhje me punën e stafit të KLSH-së, ne jemi të prirur që të respektojmë nga ana procedurale me dokumentacion për të qenë sa më efikasë dhe për të parandaluar edhe problematikat më të rëndësishme. Ne jemi të gatshëm të komunikojmë në mënyrë të menjëhershme me përfaqësuesit e institucioneve, të cilat janë në auditim dhe kjo për t'i dhënë një zgjidhje sa më të shpejtë dhe sa në konkrete të situatave.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi**- Pyetja, nëse nuk gabohem, nuk ishte për institucionet, por ishte për KLSH-në.

**Arben Shehu** - Po, në lidhje me komunikimin...

**Eduard Shalsi** - Jo, zonja Koliqi tha që nga njëra anë ju keni një vakum punonjësish, pra, keni në organikë një numër punonjësish, i cili nuk është plotësuar dhe, nga ana tjetër, keni kërkuar një shtesë, por ka edhe një fond page, i cili nuk është ezauruar. Kjo ishte pyetja, nëse nuk gabohem.

**Arben Shehu** - Pyetja bënte fjalë për rastet kur....

**Emilia Koliqi**- Shpeshherë institucionet janë të paqarta për mënyrën sesi duhet të operojnë për çështje të ndryshme dhe duhet t'i drejtohen Kontrollit të Lartë të Shtetit për marrjen e asistencës ligjore, ose procedurale, në mënyrë të tillë që të mos i quhet shkelje në momentin kur i vjen KLSH-ja. A keni ju një komunikim, ose një platformë komunikimi me institucionet, apo duhet të komunikohet vetëm nëpërmjet shkresave dhe, nëse është e tillë, sa ju janë drejtuar për këshillim dhe sa kanë marrë përgjigje?

**Arben Shehu** - Kjo është një tjetër pyetje. Megjithatë, ideja është që, në radhë të parë, institucionet në përgjithësi duhet të kenë një lloj pune vetkontrolluese dhe për më tepër një lloj investimi për rritjen e nivelit profesional, në mënyrë të veçanet rritjes profesionale për njohjen e ligjit. në rast se punonjësit e institucioneve në tërësi do të kenë një nivel të lartë të njohjes së legjislacionit në tërësi, edhe situata të tilla që ju mund të mendoni se ndodhin në praktikë, do të jenë të reduktuara. Megjithatë, ne jemi të gatshëm që të jemi në komunikim në çdo moment dhe të bashkëpunojmë në lidhje me zgjidhjen e situatave të tilla.

**Marjola Llanaj** – Në vijim të pyetjes që bëri zonja Koliqi, ne kemi institucione që na janë drejtuar, më konkretisht, për interpretime të caktuara të legjislacionit. Në fakt, ne nuk mund të bëjmë interpretim të legjislacionit, sepse ne kemi si detyrë auditimin e zbatimit të këtij legjislacioni. Megjithatë, ne kur shkojmë nëpër institucione gjithmonë bashkëpunojmë

me ta dhe rekomandimet lihen në funksion të legjislacionit, të ngërçit që ata ndiejnë, të rekomandimeve organizative dhe gjithmonë janë të mirëpritur, ka një platformë të caktuar edhe elektronike, edhe në mënyrë shkresore, edhe nëpërmjet komunikimit të pritjes së tyre. Pra, komunikimi është i gjithmonë i vazhdueshëm me institucionet. Ne nuk jemi barrierë e hekurt për institucionet, por jemi gjithmonë bashkëpunues që puna jonë të jetë një vlerë e shtuar, të ketë rekomandime, të cilat përmirësojnë punën e tyre, në mënyrë që performanca e tyre të jetë në funksion të taksapaguesve. Kështu që Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është në funksion të taksapaguesve, kështu që Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është në formën e një muri të ashpër, në të cilin vijnë dhe përplasen të gjitha problematikat, por ne asistojmë aq sa mundemi dhe sa na lejon ligji në këtë pikë.

Për sa u përket pyetjeve të tjera, që, në fakt, janë disa, për një pjesë e tyre ndoshta do të ishte mirë që për shkak të statistikave që përmenden në to, ose përqindjeve të caktuara, të cilat ju i doni me shifra konkrete, që ne t'juja përcjellim në mënyrë elektronike, ashtu siç kryetari e përmendi, në vijueshmëri, bazuar në pyetjet e tyre.

Në fakt, unë dua të sqaroj vetëm dy koncepte, që u diskutuan gjatë nga të dyja zonjat e nderuara: është koncepti i efektit negativ financiar dhe metodologjia e dëmit ekonomik. Ju e dini shumë mirë që dëmi ekonomik është i matshëm, është konkret, ka përgjegjësi konkrete dhe çështje konkrete, ndërkohë, efekti negativ financiar në metodologjinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit më shumë i referohet një produkti, i cili është përfituar, por procedurat deri në përfitimin e këtij produkti kanë ceduar, domethënë, nuk janë të rregullta. Këtu flas në parim për rastin e prokurimit publik, i cili zë pjesën më të madhe të këtyre efekteve negative financiare për buxhetin e shtetit. Ne shohim fonde publike, të cilat prokurohen, por në vetvete procedura e tenderit ka specifikime teknike të ngushta, ka ngushtim konkurrence dhe ka të gjitha problematikat që ne i përmendem pak më herët, të cilat, në fakt, përdorimi më i mirë i tyre do të na sillte përfitime më mira dhe produkte më të mira për institucionin. Domethënë, nuk është arritur efienca, efektiviteti dhe optimizimi i përdorimit të fondeve publike. Për ne këto konsiderohen përdorim i fondeve pa efektivitet. Metodologjia është e qartë, sepse brenda institucionit ka metodologji të sakta, ka manuale të auditimit të përputhshmërisë, manuale të auditimit financiar apo edhe të performancës.

Lidhur me pyetjen e futjes në praktikë të metodologjive më të mira për auditimin, ne jemi koshientë që puna gjithmonë kërkon përmirësim, kërkon që gjithmonë të jemi koherentë edhe me zhvillimet e institucioneve supreme të auditimit, të cilat paraqesin manuale dhe udhëzues, që i përditësojmë vazhdimisht. Ne përpiqemi maksimalisht që brenda institucionit të kemi trajnime të vazhdueshme, përditësim dhe rregullim të këtyre manualeve. Megjithatë,

dua të theksoj diçka që është shumë e rëndësishme. Pavarësisht se metodologjitë janë bashkëkohore, janë moderne, ato janë udhëzues të vlefshëm për çdo institucion, ashtu edhe për ne në punën e përditshme. Ne jemi koshientë që këto metodologji duhet të përshtaten me kulturën e vendit. Parimi i tij thelbësor, kur udhëzon të gjitha institucionet e aludimit, është: “Çdo institucion apo çdo vend që përqs metodologjitë të tilla të auditimit duhet ta përshtatë me kulturën e vendit”. Meqenëse ne jemi një vend, i cili po lufton ashpër kundër korrupsionit dhe ne jemi një institucion që është në këtë betejë dhe është i renditur fort në këtë betejë, ne këto metodologji i kemi të përshtatura me kulturën e Shqipërisë, sepse ne punojmë këtu.

Lidhur me departamentin e performancës për përcaktimin e fushave me risk. Ky është një dokument që ata po punojnë, është një departament me njerëz me *background* shumë të mirë. Ata po punojnë për të përcaktuar këto lloj fushash dhe kanë një *dateline* të përcaktuar, besoj se do ta përfundojmë brenda këtij viti.

Në lidhje me pyetjen: si përcaktohen auditimet dhe tematikat e performancës, dua t’ju sqaroj që çdo tetor-dhjetor institucioni i KLSH-së bën planifikimin vjetor të auditimeve të KLSH-së, që do të bëjë për vitin e ardhshëm. Kështu që çdo departament ka një metodologji të caktuar dhe mirëpërcaktuar, të cilën e kemi hartuar në bashkëpunim me kolegët tanë polakë. Kjo është një metodologji, që përcakton fushat, gradat, databaza riformatohet çdo ditë dhe çdo departament qartëson dhe sjell propozimet e tij, të cilat diskutohen si në nivel menaxheria, po ashtu edhe në nivel departamenti. Më pas kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit i përcaktohet dhe i propozohet një program i mirëmenduar për ato fusha që ne i vlerësojmë me risqe, në bazë të dinamikave apo situatave të vendit, kuptohet edhe ato që kanë qenë në vijimësi, të cilat kanë qenë me risk.

Më hollësisht mund t’ju vëmë në dispozicion çdolloj pyetje, që ne nuk mund t’ju japim dot ekzakt me shifra, por mund t’ju vëmë në dispozicion në çdo kohë.

Këtu u kërkua një databazë për observacionet dhe sa për qind të tyre ne marrim në konsideratë, në fakt, observacionet janë të diskutueshme dhe janë kompetenca të grupit të auditimit. Institucionet kanë gjithmonë të drejtë, që në fazën e aktit, të paraqesin observacionin e tyre, merren në konsideratë, shikohen, përpunohen nga grupet dhe më pas kalojnë në sistemin tonë të brendshëm. Pra, hartohet projektraporti. Ju i dini hapat shumë më mirë.

**Eduard Shalsi** – E nderuar drejtoreshë, nuk është çështja i dinë hapat apo nuk i dinë hapat, pyetja ishte konkrete dhe do të doja të ishit sa më konkrete në përgjigjet tuaja.

Pyetja në rastin konkret ishte: a ka një databazë që nga X observacione 80%, 90% apo 3% nuk janë marrë parash apo janë marrë parasysh? Pra, të mos kalojmë në shpjegimin e

observacionit, sepse e edhe relatorët kanë eksperiencë dhe Komisioni është i Ekonomisë. Pra, nëse ka një përgjigje, në rregull, nëse nuk ka një përgjigje dhe duhet kohë, përsëri në rregull.

**Marjola Llanaj** – Individualisht në çdo raport auditimi është e përcaktuar që janë marrë në konsideratë observacionet pjesërisht, plotësisht ose jo. Ndërkohë, databazë të ndërtuar për observacionet nuk ka.

**Eduard Shalsi** – Pra, nuk ka një përgjigje, që të themi nga 100 observacione që janë bërë, 5 janë marrë, 10 ...

**Marjola Llanaj** – Është e vështirë për t'u hartuar, por nuk kemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Eduard Shalsi** – Në rregull, mund të vijojmë me pyetjen tjetër, ndërkohë që po mbajmë shënim.

**Marjola Llanaj** – Në lidhje me departamentin e IT-së, departamenti i IT-së është relativisht një departament i ri dhe te homologët tanë, që nuk e kanë ngritur këtë departament IT-je, niveli i auditimeve është 7-8 auditime janë maksimale për këto lloj auditimesh.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në gjysmën e vitit 2021 ne ishim në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që na detyronte t'i auditonim këto 61 bashki. Kemi bërë maksimumin me ato burime njerëzore që kishim në dispozicion, në këtë rast shpjegohet edhe arsyeja pse kemi kërkuar rritje të numrit të audituesve. Ne kemi bërë 46 auditime dhe 7 auditime që janë evaduar. Sivjet jemi me ritme shumë më të mira për realizimin e auditimit të këtyre bashkive. Kryesisht janë auditime, sepse vjet ne planifikimin e kishim 22 auditime për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kishin edhe raport përputhshmërie, edhe financiar, ndërkohë sivjet është pak më e thjeshtë, sepse ne kemi 1 vit korrent financiar dhe besoj se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Valbona Gaxha** – Së pari, dua të bëj një saktësim, ju i referoheni numrit të punonjësve 233, por ky është numri i planifikuar për vitin 2022.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më falni, sepse kam shënuar numrin 233!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, është parashikuar një rritje për 15 punonjësish në vitin 2022. Përgjigjja në një rast të tillë është: institucioni i KLSH-së, si çdo institucion tjetër i administratës publike, është një institucion dinamik dhe, ashtu siç ka edhe rekrutime, ka edhe largime, ka edhe dalje në pension, ka dorëheqje, ka lëvizje paralele nga KLSH-ja në institucione të tjera, po brenda administratës publike. Ne mund t'ju vëmë në dispozicion një statistikë edhe për procedurat e

punësimi që kanë qenë në periudhën dhjetor, të cilat janë mbyllur në janar dhe në fillim të shkurtit. Kanë qenë të paktën 10 procedura të hapura për punësimin, pikërisht për të plotësuar numrin e parashikuar. Ashtu siç e thashë, është dinamikë dhe asnjëherë nuk pretendojmë që ky numri 218 të jetë statik dhe të realizohet në një moment të caktuar, sepse në një muaj më pas përsëri mund të jetë i ndryshueshëm për shkak se ka edhe largime për arsye nga më të ndryshmet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, mund t'jua vëmë në dispozicion statistikën edhe me bazë mujore, pikërisht për të shprehur edhe dinamikën që sapo thashë.

Për sa i përket fondit të pagave, ndoshta do t'i kaloj pyetjet jo sipas radhës, është e vërtetë që janë kërkuar dy shtesa dhe shtesa e dytë i përket pikërisht kësaj shtese të numrit të punonjësve që është kërkuar pasi ka dalë dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, ku detyron në njëfarë mënyre KLSH-në për të kryer auditimet financiare mandatore për vetëqeverisjen vendore.

Gjithashtu, është parashikuar një program incentiv edhe për rritjen në kategori të punonjësve, e cila do të ndryshojë pak strukturën e pagave, sepse kemi disa auditues shumë të mirë, që për vite të caktuara janë në një kategori më të ulët dhe ka ardhur koha që ata të promovohen, patjetër kjo ka ndikimin e saj në fondin total të pagave.

Jemi munduar që për vitin 2022 kërkesat të jenë më të qëndrueshme, por këtu do ta lidh pak edhe me pyetjen në lidhje me vlerësimin 3, pra për performancën, sepse vlerësimi i performancës së institucionit bazohet mbi disa komponentë dhe midis tyre është edhe pavarësia. Për sa kohë buxheti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, pavarësisht se kalon vetëm nëpërmjet Kuvendit dhe Komisionit të Ekonomisë, përsëri ne jemi objekt i ndryshimeve nëpërmjet akteve normative.

Së fundi, patëm një shkurtim të fondeve. Aktualisht, me një akt normativ, pavarësisht solidarizimit me situatën për krizën energjetike dhe shkurtimin e shpenzimeve të të gjithë administratës, përsëri do të donim që ky fond ose këto shkurtime shpenzimesh të ishin paraprakisht të diskutuara me institucionin. Megjithatë, KLSH-ja, pavarësisht si një institucion i veçantë dhe i pavarur, mbetet një institucion si gjithë të tjerët, dinamik, me ndryshimet dhe me impaktet e veprimeve të tjera vendimmarrëse të qeverisë.

Për sa i përket pyetjes në lidhje me parashikimin e një auditimi performance për objektivat e qëndrueshëm të OKB-së, dua t'i referohem një vlerësimi që ka bërë Banka Botërore në kaudrin e kornizës PEFA, dhe kjo u bë në dhjetor, ku është bërë një vlerësim se si është përgatitur kuadri ligjor në Shqipëri për ndryshimet klimatike, pjesë e objektivave të

qëndrueshëm strategjikë, raporti i tyre ka ardhur vetëm dy ditë më parë. Kështu që do të mbetet në diskutim dhe në shqyrtim të institucionit për të saktësuar se ku do të jetë konkretisht objektivi strategjik mbi të cilin do të jetë edhe objekti i auditimit.

Nga informacioni që unë kam, pjesë e planit të auditimit të vitit 2022, për shkak se ka një vëmendje të shtuar për këto objektiva të OKB-së të vitit 2030, është dedikuar një auditim performance, por që ka në fokus kuadrin ligjor dhe rregullator. A është e përgatitur Shqipëria për shqyrtimin dhe auditimin e këtyre objektivave të qëndrueshëm? Faktikisht këto objektiva janë afatgjata edhe për qeverinë.

Në lidhje me financimin e huaj, dua të saktësoj se marrëveshja është lidhur në vitin 2020, ndoshta ajo që iu referoheni për vitin 2016 ka të bëjë me fondet IPA, Ai është një tjetër projekt, që është finalizuar në vitin 2018 dhe ka qenë projekti i binjakëzimit me SAI-n e Polonisë. Ndërsa projekti i vitit 2020, me mbështetjen e ambasadës zvicerane, nuk është realizuar, sepse të tria procedurat e prokurimit nuk rezultuan të suksesshme gjatë vitit 2021.

Ne gjykojmë se ka një tërheqje të operatorëve ekonomikë, në këtë rast të konsulentëve, sepse kërkohen konsulentë të mirëfilltë ndërkombëtarë dhe lokalë që kanë një eksperiencë. KLSH-ja nuk është se nuk ka bërë auditime të koncesioneve, por i ka parë ato në kuadrin e zbatimit të kontratave. Auditimi i një koncesioni ka shumë komponentë, duke filluar që nga gjeneza, nga projekti DEA, studimi i fizibilitetit, përfitueshmëria etj., kështu që kjo kërkon një ekspertizë të veçantë dhe, duke qenë se numri i koncesioneve është shumë i lartë, kërkesat për t'i audituar këto koncesione, po ashtu, janë të larta, kërkohet edhe hartimi i një manuali specifik për auditimin e këtyre koncesioneve. Kështu që, qasja e operatorëve ekonomikë ose e konsulentëve ka pasur një lloj hezitimi.

Ne jemi në kuadër të tenderimit. Vetëm pak ditë më parë shpallëm përsëri procedurat dhe shpresojmë shumë që të ofrohen ekspertë, sepse do të ishte në të mirë të zbatimit edhe të buxhetit të investimit me financim të huaj.

Raporti ka një kapitull të veçantë në lidhje me komunikimin. Ne përdorim të gjitha format tradicionale të komunikimit dhe ndjekim një strategji të dyanshme komunikimi, pra jemi të hapur për të dhënë dhe për ta marrë informacion, kjo në kuadër të programit të transparencës. Pra, jemi të hapur për çdo ankesë, indicie apo denoncim që vjen, në mënyrë që ta përdorim jo vetëm për shqyrtimin e rastit apo individit në fjalë, por edhe si objekt i një auditimi të posaçëm apo për t'u shqyrtuar gjatë procesit të auditimit, nëse ai është në proces.

Faqja zyrtare e internetit përditësohet rregullisht me njoftime. Jemi duke e parë mundësinë e krijimit të një dritareje për të *chat*-uar drejtpërdrejt me një person kontakti për



një pyetje që mund të jetë e thjeshtë dhe mund të japë një sqarim më të drejtpërdrejtë dhe më operativ të shqetësimit të qytetarit.

Në lidhje me auditimet IT-i, do të shtoja se ne jemi në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes me SAI-n e Norvegjisë dhe në këtë kuadër ka një program të dedikuar që do të shtrihet përgjatë një viti, në lidhje me trajnimet për auditimet IT-i dhe do të konkludohet edhe me një auditim pilot në fund të vitit.

**Eduard Shalsi** – Zonja Gjylameti, për procedurë.

**Blerina Gjylameti** – Meqenëse pjesa e raportimit të veprimtarisë së KLSH-së ka një interes shumë të madh, pyetjet e anëtarëve të komisionit janë të shumta, po ashtu edhe përgjigjet do të duhet të jenë ezauruese, unë mendoj të bëjmë të gjitha pyetjet dhe t'u japim mundësi të na kthejnë përgjigje të plota dhe të detajuara në funksion të sqarimit të të gjitha pikëpyetjeve që ne kemi. Pra, mendoj të bëjmë të gjitha pyetjet dhe të kemi një seancë tjetër me përgjigjet.

**Eduard Shalsi** – E kuptova sugjerimin.

Në fakt, kemi kërkuar që të bëhen disa pyetje paraprakisht, sepse ndoshta volumi i madh dhe mbajtja e shënimeve e bën pak më të vështirë procesin. Unë jam shumë dakord dhe nuk kam asnjë problem, madje shërbimet e Kuvendit po i zbardhin edhe një herë pyetjet e bëra deri tani për të na i vënë në dispozicion. Pra, unë jam shumë dakord. Nëse edhe ju jeni dakord, mund ta vijojmë mbledhjen me marrjen e pyetjeve dhe pastaj e kanë shumë më të lehtë për të ardhur me përgjigje konkrete.

A jemi dakord? A ka ndonjë kundërshtim?

**Jorida Tabaku** – Unë mendoj që diskutimin e sotëm ta vazhdojmë, t'i bëjmë të gjitha pyetjet, të bëjmë edhe diskutimet dhe pastaj organizojmë edhe një seancë tjetër, ku vijnë përgjigjet dhe mund të diskutojmë edhe rezolutën ose mendimet, por sot mendoj që mos ta ndërpresim.

**Eduard Shalsi** – Jo, jo, nuk do ta ndërpresim. Po themi që një variant është që t'i bëjmë të gjitha pyetjet dhe pastaj të vijmë në një dëgjuesë tjetër, ku do të jetë shumë më koncize, për shembull, pyetja 1 nga zonja Tabaku dhe vijon me përgjigje, pastaj pyetja 2 e kështu me radhë. Mendoj se kështu ata kanë edhe kohën e mjaftueshme për ta absorbuar mirë pyetjen. Ky ishte sugjerimi.

**Jorida Tabaku** – E kuptova sugjerimin. Unë u përpoqa ta sqaroja pak më shumë. Sot, besoj se do t'i bëjmë të gjitha pyetjet dhe mund të bëjmë edhe një pjesë të diskutimit, sepse sot u bë prezantimi i raportit dhe pastaj, kur të kemi përgjigjet e pyetjeve, mund të kemi edhe qëndrimin final.

**Eduard Shalsi** – Çështja është që a mund të bëjmë një diskutim mbi përgjigje pyetjesh ta pamarra.

**Jorida Tabaku** – Jo, mbi prezantimin dhe mbi çështjet që u ngritën nga diskutimet.

**Eduard Shalsi** – Dakord, mund t’i bëjmë disa komente.

Pra, a jeni dakord të vazhdojmë në këtë mënyrë? Dakord.

Seanca transmetohet online dhe shërbimet e Kuvendit po mbajnë shënim. Pra, mund ta shihni edhe më me qetësi pjesën e pyetjeve.

Atëherë, po vazhdojmë duke marrë pyetjet dhe i japim mundësi të bëjnë diskutim mbi gjetjet e raportit dhe pastaj rikthehemi me përgjigjet e pyetjeve, që besoj do të jenë shumë më koncize, si dhe do të ketë kohë edhe për t’u përgatitur.

Atëherë, vijojmë me pyetjet. Ato që janë bërë deri tani janë mbajtur shënim.

Urdhëroni, kryetar!

**Arben Shehu** – Nëse ju e vendosni, vazhdojmë me pyetjet dhe në përfundim pastaj, për aq sa mundemi të jemi shterues në përgjigjet, t’i trajtojmë sot, ndërsa për përgjigjet që do të duhet të jenë të detajuara, jemi të gatshëm t’u përgjigjemi në një moment tjetër.

Urdhëroni, zoti Xhelili!

**Alban Xhelili** - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se do të na ezaurohen pyetjet dhe na dalin si të pakuptimta.

Unë do ta nis, pak a shumë, nga fundi. Në medie, përpara se të na vijë raporti, kemi dëgjuar për 616 milionë euro dëm ekonomik. Përpara se të dilte ky raport në medie, KLSH-ja ka qenë e detyruar të jepte një shpjegim, të cilin e dha pak më parë dhe unë e kisha shënuar si sugjerim, që duhej të bënte një sqarim midis dëmit ekonomik dhe efekteve negative për shkak të parregullsive. Dëmi ekonomik është diku te 150 milionë euro dhe, për këtë arsye, nuk duhej të ishte bërë kjo bujë negative në raport me gjetjet e KLSH-së dhe me parregullsitë në këtë shtet. E para kjo.

E dyta, nuk arrij të kuptoj, nëse KLSH-ja është një institucion që ka vijimësi, apo jo. Pse? Sepse shikoj treguesin e dobishmërisë së auditimit në vitin 2020 me atë të vitit 2021 dhe shikoj që në vitin 2020 raporti është për çdo 6.2 lekë zbulim, 1 lekë janë shpenzimet në buxhetin e shtetit për KLSH-në. Në vitin 2021, për çdo 56 lekë, 1 lekë janë shpenzimet në buxhetin e shtetit për KLSH-në.

Ky raport tregon që ka diçka që nuk shkon në raportin e njërit vit ose në tjetrin dhe unë nuk e di se çfarë treguesi përdorin në njërin vit dhe në tjetrin. Këtë unë e di, por dua ta dëgjoj nga përfaqësuesit e KLSH-së.

Në vitin 2020, tek treguesit e dobishmërisë, 1 ose 6.2 me 1, dëmi ekonomik reflektohet në 694.1 milionë lekë dhe ka të bëjë pak edhe me pyetjet që bënë kolegët më parë.

Unë e dua në vlerë konkrete, se sa nga këto kanë hyrë realisht në buxhetin shtetit, sepse vetëm ajo që ka hyrë realisht në buxhetin e shtetit ose që është në proces gjyqësor, që mund të hyjë në buxhetin e shtetit, është dëmi ekonomik faktik i shkaktuar, sepse, në qoftë se flasim për vlera virtuale, asnjëherë nuk do të kemi rezymenë e një situatë të qartë të problematikave.

Nga 205 subjekte të audituara me 158 misione të evaduara, ku 114 janë me dhënie opinion, u tha këtu që patjetër ka pasur edhe relacione. Gjëja që më habiti që fakti se ishte e vështirë të mbaje një evidencë në lidhje me relacionet e arritura dhe konsideratat e marra. Nuk besoj, sepse KLSH-ja ose inspektorët e KLSH-së, e dinë shumë mirë se sa evidencë kanë mbajtur në 205 subjekte të audituara. Evidencat e mbajtura mund të jenë me dhjetëra mijëra. Pra, nuk është e vështirë të mbahet një evidencë për relacionet dhe për marrjen në konsideratë të këtyre evidencave.

Kur flas për 114 misione, për të cilat është dhënë opinion, është dhënë opinion i pakualifikuar në disa raste, dhe i kualifikuar në disa raste të tjera. Shpeshherë krijohet konfuzion midis “i kualifikuar” dhe “i pakualifikuar”. I pakualifikuari, thënë shqip, është më i mirë. Pra, është një opinion, i cili paraqet një situatë të mirë. Pavarësisht se pyetjen e kisha shënuar, që doja të dija në lidhje me opinionin kundër, kur opinionin kundër ose refuzimi i opinionit është opinionin më negativ, pak a shumë unë doja të dija se cila ka qenë problematika, sepse kam lexuar gjithë raportin dhe kam parë se problematika ka të bëjë më shumë me llogaritë e pasqyruara, lidhur me aktivet ose me të drejtat dhe detyrimet. Edhe këtu do të kisha një këshillë: hartuesve të raportit do t’i rekomandoja që, nëse përmendin SKK, SNK, të mos përdorin termin AQT. Termi AQT nuk ekziston më. Pra, aktive të trupëzueshme të qëndruara nuk ekziston më. Janë aktive afatgjata materiale, nuk ka më as term: ndryshim gjendjeje inventari. Këtë e keni edhe te faqet 21-37 të raportit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, unë do të thosha që të paktën ky të mos përdoret në raport.

Tani, kam disa problematika lidhur me raportin, që janë të përfshira në këtë raport, që janë në disa institucione. Unë po marr këtu pjesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Kam disa qëndrime të mbajtura nga inspektorët e KLSH-së. Po deshët, unë jua them rastet kur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po pra, po, ka të bëjë me pyetjet kjo.

Në një rast është një subjekt, që po të futeni në QKB, është prodhim dhe shitje materialesh ndërtimi. Vetëm KLSH-ja mund ta trajtojë rastin si shitje, sepse nëse ky subjekti prodhues do të bëjë shitje apo jo, unë nuk e di. Sepse i kanë nxjerrë detyrim këtij subjekti për kreditim të pjesshëm të TVSH-së. I thotë: ti nuk ke të drejtë të kreditosh 33 %, por 3 %, sepse je shitës. Tani, që një prodhues të mos shesë, unë këtë nuk e kuptoj.

Rast tjetër është: leje ndërtimi për personat fizikë, në emër të individit. Unë kam shqyrtuar ligjin “Për shoqëritë tregtare”, ligjin “Për Kodin Civil” dhe “Ligjin për tatimin mbi të ardhurat”, ku bëhet përcaktimi. KLSH-ja e ka trajtuar dhe ka nxjerrë dëm ekonomik për një leje ndërtimi 24 milionë, e kështu me radhë. Për katër-pesë çështje që kam konstatuar unë këtu, dëmi ekonomik i nxjerrë nga KLSH-ja është 1 milionë e 927 mijë euro mbi dëmin total ekonomik 150 milionë euro. Pra, po t’u hyjmë të gjitha problematikave këtu, për mendimin tim edhe ky dëmi ekonomik nuk qëndron.

Një pyetje që kam, është: a keni përdorur ju praktika ose dokumentacione të praktikave të auditimit të brendshëm? Pra, në çfarë raporti jeni ju me auditimin e brendshëm? Unë e kam parë në raport, që ju keni shprehur rezerva lidhur me strukturat e auditimit të brendshëm. Në disa institucione këto nuk ekzistojnë fare, por në ato që ekzistojnë. A e keni marrë në konsideratë pjesën e tyre? Tani, në një rast kam një përlllogaritje kostosh, të bërë nga ana e inspektorëve, në lidhje me një proces specifik prodhimi. Gjithashtu, në raport kam parë që ju jeni ndjekur trajnime të rregullta për punonjësit, por SMA-të përcaktojnë se audituesit mund të shoqërohen edhe me specialistë nga jashtë. Në sa raste, në këto institucione, ju jeni shoqëruar me specialistë të fushave nga jashtë, kur e keni pasur të pamundur të bëni vlerësimin? Në lidhje me inspektorët tuaj, a ka vijimësi në sektor? Pra, një inspektor që kontrollon dhe auditon një sektor të shëndetësisë, a mos vallë vitin tjetër kalon te dogana? Sepse ka të bëjë pak edhe me formimin dhe profesionalizmin, që është detyrim sipas SMA-ve.

Unë jam auditues vetë, dhe kur një institucion ka një problematikë të madhe, e do t’jua them se për cilin bëhet fjalë, që është edhe shumë i përfolur, për çudi në të gjitha zyrat e këtij institucioni më rezulton opinion i pakualifikuar për përputhshmërinë. Pra, e dimë çfarë do të thotë ASHK-ja. Tani, unë nuk e di këtë. Në një kohë që KLSH-ja ka detyrimin që të rrisë besimin e gjithë qytetarëve lidhur me pasqyrat, a mendoni ju se kjo formë e rrit besimin?

Tani unë po ju them edhe një rast: ndodh që në një institucion të ketë vakancë prej një viti. Çfarë qëndrimi keni mbajtur ju? Sepse e kam parë që ky rast nuk është trajtuar në raportin tuaj. Në të gjitha rastet duhet të mbani një qëndrim objektiv, sepse vetëm kështu mund të bëheni të besueshëm. Po e paraprij edhe opinionin tim, për të ndjekur edhe

standardin tuaj: patjetër që opinionin im do të jetë i kualifikuar dhe do të ndjekë një nga ato tre variantet e opinionit të kualifikuar.

**Eduard Shalsi** – Mbarove, zoti Xhelili?

**Alban Xhelili** – Po. Falemnderit!

**Eduard Shalsi** – Fike pak mikrofonin, të lutem!

Ndërkohë, pas zotit Xhelili bëhen gati zonja Tabaku e zoti Braçe.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, kryetar, fjala për ju! Po.

**Arben Shehu** – Falemnderit, zoti kryetar!

Tani, duke filluar nga qëndrimi i parë i zotit Xhelili, sa i takon me pasqyrimin në media të gjetjeve e të konstatimeve tona në lidhje me shifrat...

**Eduard Shalsi** – Kryetar, ne ramë dakord, besoj unë...

**Arben Shehu** – Shumë shkurtimisht!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shkurtimisht! Nuk ju marr shumë kohë.

**Eduard Shalsi** – Mirë, dakord!

**Arben Shehu** – Gjithmonë, nëse më lejoni!

**Eduard Shalsi** – Në rregull! Në rregull!

**Arben Shehu** – Ideja është se ne e kemi paraqitur para Kuvendit të Shqipërisë, saktësisht pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, raportin, punën tonë zyrtare, dhe i referohemi këtij raporti. Ato shifra janë të pasqyruara me korrektesën maksimale në vazhdimësi, ndaj pa diskutim që u qëndrojmë.

Në lidhje me ato pakënaqësi që ka zoti Xhelili, unë do të mirëkuptoja...

**Alban Xhelili** – Nuk janë pakënaqësi, jo. Unë nuk shpreha pakënaqësi, por shpreha problematikë.

**Arben Shehu** – Patjetër!

**Eduard Shalsi** – Zoti Xhelili, të lutem, ta mbarojë fjalinë dhe pastaj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë, një sekondë!

E kemi lënë të flasim me një mikrofon. Ndizet mikrofonin, mbaron, dëgjon, nuk biem dakord...

**Arben Shehu** – Atëherë, problematikat, nëse doni ta cilësojmë kështu, problematikat....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ju marr shumë kohë, nëse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Si? Do t’ia bësh me shkrim?

**Erion Braçe** – Jo, ia çoj me video.

**Eduard Shalsi** – Po pse me video?

**Arben Shehu** – Nuk ju marr shumë kohë.

**Eduard Shalsi** – Po pse me video?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

S’e di pra, s’e di tani. HiTech.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më duhet të menaxhoj personalitete dhe deputetë të ndryshëm në qasje, kështu që...

**Arben Shehu** – Dua t’ju them se edhe për raste të veçanta, ne kemi qenë dhe jemi në dispozicion jo vetëm për përfaqësues të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, që është detyrim bazë, por edhe për një qytetar. Për më tepër, ne kemi qenë në dispozicion në lidhje me problematikat e ngritura nga zoti Xhelili, të cilat janë adresuar paraprakisht në institucionin tonë. Kemi qenë në komunikim për situata të veçanta, të detajuara, të ngritura nga zoti Xhelili paraprakisht, para kësaj seance, por edhe në lidhje me raste të veçanta për subjekte private që operojnë në bashkinë Durrës, si njësi administrative, e cilësoj këtë, dhe besoj se kemi dhënë përgjigje. Tani, nëse qëndrimi ynë nuk është i pranueshëm për mendimin e zotit deputet, se kjo është diçka tjetër, megjithatë ne në vazhdimësi do të jemi të gatshëm që në çdo moment të vihemi në dispozicion të secilit prej anëtarëve të komisionit, në veçanti të zotit Xhelili dhe të japim një përgjigje të saktë.

**Eduard Shalsi** - Të gjithë deputetët janë të barabartë dhe nuk ka një në veçanti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një sekondë! Bëri një ndërhyrje zonja Tabaku.

Nëse biem dakord që të bëjmë pyetje dhe pastaj në seancën e radhës do të marrim përgjigje, do të vijojmë. Nëse pas çdo lloj pyetje do të kërkoni dhe do të thoni: “Mund të shprehet”, pra, nga ky moment e tutje do të depozitoni pyetjet. Pastaj pasi të depozitoni pyetjet, nëse ka komente apo diçka për raportin, do të kalojmë te pjesa e diskutimeve.

Zonja Tabaku, pyetje.

**Jorida Tabaku**- Faleminderit!

Së pari, një herë më lejoni të shpreh, zoti kryetar, me gjithë vëmendjen e kolegëve të nderuar besoj, vlerësimet për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë punës në komisionin hetimor unë kam vënë re vështirësitë që ka një institucion si KLSH-ja, dosjet

voluminoze që na kanë ardhur me të gjitha informacionet, komunikimet që ata kanë me institucionet. Unë e kuptoj se çfarë vështirësie kanë ata për të kërkuar dhe për të marrë një informacion, mund të kenë nisur mbi 15 shkresa të caktuara tek institucioni dhe nuk vjen përgjigjja, pas shumë insistimesh, shikoj përgjigjet e institucioneve shqiptare që nuk japin informacione, që refuzojnë autoritetin e KLSH-së, besoj se është çështje që duhet të jetë edhe pjesë e rezolutës. Kur kemi vështirësi ne që jemi deputetë, kur ka vështirësi KLSH-ja për të marrë informacione, për të kryer punën e saj, që i ka vënë ligjvënësi me një ligj të caktuar, besoj se kjo është shumë më e vështirë për qytetarët. Duke u përpjekur të përmbledh disa nga çështjet në pyetje, pastaj, shumë i nderuar zoti kryetar, rezervoj të drejtën të bëj dhe komente në fund.

Të dhënat e komisionit të posaçëm që i paraqitën këtu, por njëkohësisht dhe raporti i performancës shoqëruar me dy raportet dhe dy analizat që ka bërë KLSH-ja për Covid-in, por edhe për rindërtimin, që janë 3 raporte në total, besoj se deputetët i kanë lexuar, më kanë përforcuar shqetësimin që kam shprehur në këtë komision herë pas here nga pikëpamja e menaxhimit të buxhetit. Është e vërtetë se ky nuk është një raport për buxhetin, por raporti i performancës, i cili në vetvete tregon dhe problematikat që ka zbatimi i buxhetit.

Zoti kryetar tha se ka risqe që cenojnë financat publike, arbitrazhi kryesisht dhe PPP-të që janë risqe reale për buxhetin e shtetit, që i kemi përmendur herë pas here në këtë komision, njëkohësisht 25% e shpenzimeve, pra 1 në 5 lekë ose 15% në kontrata projektsh, pra, 1 në 1,5, raporti është më i vogël sesa të shpenzimet, konsiderohen dëm ekonomik. Për mua këto të dhëna janë shumë shqetësuese: 1 në 5 lekë që shpenzohet është dëm ekonomik, pavarësisht treguesve që mund të ketë, që i përmendi zoti Xhelili, por për mua ky është treguesi që i intereson këtij komisioni, sesi përdoren fondet publike.

Me shqetësim kam vënë re disa elemente, që dua t'i përmend në lidhje me kontratat e prokurimit, ku ka rezultuar në shumë raste dhe shumë proceduara që janë zhvilluar përtej nevojave të planifikuara dhe pa fondet e buxhetore. Kur e kam thënë këtë gjë këtu në komision kur u diskutua buxheti, se zhvillohen procedura prokurimi pa fonde të planifikuara ose pa fonde të përcaktuara dhe në buxhetin e shtetit, edhe në programin buxhetor afatmesëm është hedhur i gjithë komisioni bashkë me ministren e Financave. Kjo ndodh jo vetëm për prokurimet publike, siç thotë raporti i KLSH-së, por ndodh njëkohësisht dhe për kontratat e koncesioneve dhe PPP-ve, ku një pjesë e madhe e këtyre kontratave janë në shkelje, sepse nuk kanë parashikime të sakta buxhetore. Një pjesë e madhe e këtyre kontratave shfaqen me një vlerë shumë të ulët në buxhetin e shtetit, më pas për të rritur vlerën në vitet pasardhëse në mënyrë që të akomodohen projekte të tjera. Shqetësimi i ngritur në këtë rast është që buxheti

i shtetit ka realizuar një pjesë të madhe të shpenzimeve pas datës 15 nëntor, që nuk duhet të ishte rasti: edhe planifikime fondesh, edhe tenderime, gjë që tregon për sisteme të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të cilat janë me një cilësi jashtëzakonisht të ulët. Buxheti i shtetit e ka humbur kuptimin, në gjykimin tim, KLSH-ja thotë se mungojnë sistemet, pra e ka humbur kuptimin e një buxheti që planifikohet që në fillim të vitit. Nëse ne së pari kemi shkelje në përdorimin e fondit rezervë, siç thuhet në raportin e KLSH-së, se përdorimi i fondit rezervë lë për të dëshiruar, jo vetëm në rastin e Covid-it, por në përgjithësi. Kushedi se në sa raste kanë ardhur përfaqësues të Ministrisë së Financave këtu që kanë thënë se është e llogaritur në fondin rezervë dhe nuk e llogaritim në buxhetin e vitit. Fondi rezervë nuk është një fond dytësor i buxhetit të shtetit, por është një fond që përdoret në raste dhe për nevoja ekstreme, jo si një fond garancie që mbahet sa herë që ka nevojë për të futur dorën cilido ministër për të bërë procedura konkurruese prokurimi.

Kam disa shqetësime. Së pari, për Rrugën e Arbrit, a ka një auditim ose një proces që institucioni juaj është e duke ndërmarrë? Rruga e Arbrit për mua është një nga kontratat koncesionare që nisi me një vlerë 120 milionë euro dhe ka përfunduar 54,8 miliardë lekë, thuhet në buxhetin e vitit të kaluar. Është një shifër që e ka kaluar 5 herë vlerën fillestare. Kam 2 muaj që u dërgoj shkresa institucioneve për të marrë informacione: çfarë u bë me tunelin, pse u prish? Pse përbërja gjeologjike ishte e tillë që nuk ishte marrë parasysh që në projekt? Por e kam të pamundur të marr informacione, sepse mi kthejnë të gjitha shkresat mbrapsht.

Çfarë ka ndodhur me Unazën e Tiranës? A ka një hetim për të?

Ju në fakt, i përmendni kontratat e shëndetësisë dhe të infrastrukturës si problematika, por në raport unë gjej shqetësim për 3 kontratat e shëndetësisë, që i keni përmendur në mënyrë specifike, ndërkohë që për infrastrukturën mund të keni të tjera.

Për rrugën Kardhiq-Delvinë, 15 milionë euro pak kohë më parë, negociim pa shpallje. A ka një proces hetimi ose auditimi nga ana juaj për mirëmbajtjen e rrugëve? Janë 40 kontrata për mirëmbajtje të rrugëve, të cilat janë në mbivendosje me njëra-tjetrën, në gjykimin tim, por njëkohësisht në mbivendosje dhe të kontratave të prokurimit publik që bën qeveria.

Kur do të dalë raporti final për auditimin e performancës për inceneratorin e Tiranës, për të cilin jam e interesuar? Shqetësim, gjithmonë lidhje me KLSH-në, në 30 vjet kanë qenë ndryshimet e raporteve paraprake me raportet finale. Për mua raporti paraprak për inceneratorët, sidomos atë të Tiranës është një nga raportet më të mira që kam lexuar në këto vite.



Në lidhje me rindërtimin, po në këtë komision, kur është diskutuar buxheti i shtetit kam ngritur shqetësim për sa u përket fondeve të rindërtimit, më saktë donacioneve dhe kredive. Një pjesë e donacioneve dhe kredive nuk janë të regjistruara edhe në buxhetin e shtetit, por njëkohësisht edhe në borxh. Sipas raportit tuaj për rindërtimin ju në mënyrë specifike thoni: “Ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka të dokumentuar informacione për mënyrën e përdorimit dhe eficiencën e arritur për çdo donacion apo mbështetje të ofruar. Nuk ka të dokumentuar aktivitetin, koordinimin, drejtimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së institucioneve të tjera për hartimin e planit të masave lidhur me zbatimin e donacioneve të huaja. Nuk ka projekte specifike dhe nuk është përgatitur dokumentacion specifik i përgjithshëm apo i veçantë si pjesë e procesit të rindërtimit”.

Dua t’u kujtoj të gjithë qytetarëve shqiptarë se sipas informacionit që keni sjellë në komision shkon në pothuajse 985 milionë euro kostoja e gjithë procesit për rindërtimin. Janë kryer një sërë procedurash prokurimi, të cilat pak nga pak po i shohim: inaugurime duke ngrënë akullore ose duke qeshur me qytetarët për pothuajse 1 miliardë euro, të cilat duket sikur nuk ka dokumentacione të sakta.

Në lidhje me Covid-in, ju keni bërë një raport të detajuar dhe për menaxhimin e situatës së pandemisë dhe të Covid-it. Në raport ka disa të dhëna shumë shqetësuese ku thuhet se në auditimin e fondeve për përballimin e pandemisë së Covid-it gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit janë konstatuar pasoja me dëm ekonomik, efekte negative në përdorimin e fondeve publike, mungesë efektiviteti, efience, realizimi i procedurave për përballimin e situatës është kryer me procedura që lënë hapësirë për interpretim ligjor, nuk ka dokumentim nga ana e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave, datat e skadencës, pasi janë konstatuar mallra të livruara në tejkalim të afateve të skadencës. Për mua ky është një shqetësim shumë i madh, kur qeveria shqiptare ka prokuruar ose ka marrë në dorëzim produkte që janë dashur për menaxhimin e pandemisë në tejkalim të datave të skadencës.

Lexova me shqetësim dhe një konstatim që ju kishit evidentuar për sa u përket respiratorëve, për të cilët kemi pasur një diskutim gjatë kohës së pandemisë dhe të Covid-it.

Ju kërkoi ndjesë kolegëve!

Procedurat e përzgjedhura, si dhe vakumet ligjore të VKM-së nr, 203, rezultuan joefektive duke mos siguruar pajisjet mjekësore të domosdoshme për Covid-19, siç janë respiratorët ose duke çuar në dështimin e disa procedurave.

Për COVID-in dhe për menaxhimin e situatës ju keni nxjerrë njëkohësisht edhe të dhëna të tjera, të cilat nga pikëpamja e menaxhimit të buxhetit janë shumë shqetësuese, sepse janë realizuar procedura pa pasur fonde të angazhuara për këto procedura. E njëjta gjë ka

ndodhur edhe me kontratat e PPP-ve dhe koncesioneve dhe prokurimet në përgjithësi, pra këtë fenomen e kam vënë re në këto 3 fusha.

Këto ishin disa shqetësime që lidheshin me pikëpamjen e menaxhimit të buxhetit.

Dy shqetësime të tjera që lidhen nga pikëpamja e dëmit ekonomik, por shkelje, meqenëse u përmend këtu edhe Agjencia e Kadastrave ose pjesa e legalizimeve, KLSH-ja ka vënë re që ka pasur legalizime të objekteve informale, duke mos zbatuar kriterin e miratimit të parcelës ndërtimore, legalizime mbi zonat arkeologjike, zonat e mbrojtura, rrugët, infrastrukturën hekurudhore. Do të doja më shumë informacion sa u takon këtyre çështjeve dhe për raste specifike në qoftë se ka.

Sa u përket kontratave me 1 euro, janë konstatuar mangësi, procesi i monitorimit dhe i raportimit nuk është i plotë. Në lidhjen e këtyre kontratave prej 1 euro janë shpallur fituese subjekte private, të cilët nuk i përmbushin kriteret për burimin e financimit të investimit. Edhe në këtë rast si deputete jam përpjekur shumë të marr listën e përfituesve, por nuk më është vënë ende në dispozicion. Nëse ju keni raste specifike, kush ka përfituar nga kontratat me 1 euro, të cilat nuk i justifikojnë burimet e financimit? Për këtë rast do të isha shumë e interesuar.

Pyetja e fundit lidhet me arbitrazhin. Ju e përmendët këtu çështjen e arbitrazheve si një nga çështjet me risk për buxhetin e shtetit. Në raport nuk arrita dot të gjeja në mënyrë specifike totalin e arbitrazheve krahasuar me raportin që ju bëni për buxhetin e shtetit, por u njoha në fakt me një arbitrazh të ri të qeverisë shqiptare për të cilin nuk kisha dijeni më parë. Në raport ju përmendni që OSHEE-ja është njoftuar nga Avokatura e Shtetit për një dëm në vlerën e 8 milionë eurove referuar çështjes së arbitrazhit të vitit 2017 me palë paditëse *Energy Financing Team AG* ku është paditur OSHEE-ja. Do të doja më shumë informacion për këtë rast, pasi nuk kam dijeni dhe është hera e parë që e dëgjoj. Nëse ka mundësi edhe për totalin e arbitrazheve dhe si është situata në këtë drejtim?

Besoj se këto ishin shqetësimet kryesore që kisha për raportin.

Në mbyllje të fjalës sime, dua të theksoj atë që tha i nderuari zoti kryetar në fjalën e tij, kërkoj ndjesë ngaqë mbajta shumë shënime për të mos i harruar të gjitha. Në tregun e sektorit të prokurimeve publike ka monopole dhe ky është një shqetësim që e kam ngritur herë pas here, kur bëhej fjalë për tenderime dhe prokurime për përqendrimin në një grup të caktuar kompanish, sidomos në rastin e infrastrukturës, por edhe në prokurimet publike në përgjithësi për disa kompani të caktuara.

Do të kisha dëshirë që këtë ta diskutonim edhe me Autoritetin e Konkurrencës, është një çështje që kam ngritur edhe atje, në qoftë se keni informacione specifike se ku janë këto

monopole, në cilët sektorë të shohim që mund të investigojmë edhe me autoritetin e Konkurrencës, sepse besoj se kjo do të na ndihmonte të gjithëve.

A keni kryer hetime në Drejtorinë e Tatimeve për situatën e rritjes së çmimeve, e cila ka qenë problematike që nga marsi i vitit të shkuar, thotë Autoriteti i Konkurrencës? A ka ndonjë hetim apo auditim specifik në Drejtorinë e Tatimeve që po realizohet se si është menaxhuar situata dhe kontrollet për subjektet? Ndoshta koha është shumë e shkurtër, sepse po flasim për një periudhë të disa muajve më parë dhe në vijim, por nuk e di nëse është pjesë e planit të punës suaj dhe të kalendarit të angazhimeve që do të ketë institucioni juaj në vijim?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zonja Dhima.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për prezantimin e raportit vjetor të performancës, njëkohësisht edhe stafin mbështetës!

Vlerësoj rolin dhe rëndësinë që ka institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike, si dhe kontributin e tij në parandalimin dhe luftën pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, përdorimin me efektivitet, me eficiencë dhe me ekonomikitet të fondeve publike.

Lidhur me raportin e veprimtarisë vjetore të institucionit tuaj do të doja të bëja disa pyetje.

Së pari, në fjalën tuaj, si dhe në raportin e paraqitur nga ana juaj theksohet se ka një dëm ekonomik prej 19 158 985 lekë, nga të cilat në fushën e të ardhurave janë 17 409 452 lekë dhe në fushën e shpenzimeve 1 749 533 lekë. Ky dëm ekonomik cilës periudhe kontrolli i përket, vetëm vitit 2021 apo një periudhe më të gjatë sesa 1 vit buxhetor, pasi dihet që institucioni juaj nuk mund të kontrollojë çdo vit institucionet publike?

Së dyti, nëse do t'u referohemi rekomandimeve të dhëna nga ana e institucionit tuaj për periudhën 2021 krahasuar me vitin 2020, ajo që të bie në sy është rritja e numrit të tyre. Për vitin 2020 janë 1430 raportime ose rekomandime për institucionet publike, për vitin 2021 janë 4251, çka do të thotë plus 2821 rekomandime; 29 përmirësime ligjore në vitin 2020, ndërsa në vitin 2021, 90 përmirësime ligjore, pra do të thotë 61 më shumë; 1107 masa organizative në vitin 2020 dhe 3074 masa në vitin 2021, pra 1967 më shumë; 294 rekomandime për masa disiplinore dhe administrative në vitin 2020 dhe 1087 në vitin 2021, pra 793 masa më shumë. Të cilit karakter janë këto masa, që janë dhënë nga ana e

institucionit tuaj dhe a janë zbatuar nga ana e institucioneve rekomandimet e vitit 2020 ose edhe të viteve të mëparshme, pasi gjithmonë programi i kontrollit nga ana juaj fillon një herë me zbatimin e detyrave të lëna dhe pastaj vazhdon me programin që ju miratoni për kontrollin që do të kryeni?

Së treti, gjatë vitit 2021 institucioni juaj është angazhuar dhe ka gjithsej 111 procese gjyqësore, nga të cilat 12 procese gjyqësore janë penale, 98 procese gjyqësore të natyrës administrative dhe 1 proces është në Gjykatën Kushtetuese. Sa prej këtyre proceseve kanë përfunduar dhe sa prej tyre janë në proces? A ka pasur rezultate konkrete?

Së katërti, për vitin 2021, nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë kryer 158 auditime nga 78 auditime që janë kryer në vitin 2020, e argumentuar kjo për shkak të pandemisë dhe të masave të Covid-it. Nëse do t'i referohemi planit fillestar të auditimit për vitin 2021, a e keni realizuar atë? Në dijeninë time më rezulton që në shumë institucione ka pasur zgjatje të afatit të auditimit dhe në disa institucione rezulton që ju keni bërë rikontroll në institucione ku është kontrolluar nga një grup i mëparshëm, duke i zëvendësuar këto grupe me grupe të tjera?

Së pesti, a keni ju një program të qartë pune si institucion ose angazhim konkret në lidhje me rezolutën që ka miratuar Kuvendi? A janë zbatuar të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e dhëna nga ana e Kuvendit?

E fundit, gjatë vitit 2021, po në dijeninë time, ka pasur disa largime nga puna nga institucioni juaj. Cilat kanë qenë disa nga arsyet e largimit të këtyre punonjësve, sepse një nga prioritetet e punës suaj është edhe trajnimi i personelit? Unë mendoj se ka pasur shpenzime për personelin që punon pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe burimet njerëzore janë një aset shumë i rëndësishëm. Dua të di se cilat kanë qenë disa nga arsyet e largimit të tyre?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zonja Denaj, e ka fjalën.

Më pas zonja Gjylameti dhe zonja Marnoi.

**Anila Denaj** – Faleminderit!

Ju falënderoj për të gjitha shpjegimet e dhëna deri tani me objektivin për t'u shkuar deri në fund të gjithave!

Unë kam nevojë të shkoj pak më larg sesa në detaje, më ndjeni nuk dua të futem në detaje operationale, duke vlerësuar edhe punën tuaj, por njëkohësisht duke menduar që ka instrumente të tjera për ta zgjidhur një çështje për një subjekt të caktuar, duke qenë edhe një komunikim i veçantë me *e-mail* për secilin prej nesh si deputetë.

Duke e lënë këtë mënjane, po kthehem tek ajo çështje që më duket më e rëndësishme edhe për veprimtarinë e KLSH-së. Unë vij nga një edukatë pune ku raportet e auditimit duhen respektuar në maksimum. Në këtë frymë më duhet t'ju them që ka diçka për të cilën efektiviteti i auditimit në përgjithësi krijon një vakuum.

Do t'ju jap 3 shembuj, mund ta kem edhe gabim, por do të doja ta diskutonim.

Së pari, ju thoni që keni 200 ente në vit të audituara dhe në funksion edhe të mungesës së një *database*, siç e thatë pak më parë, unë e kuptoj vështirësinë, por mendoj që ajo *database* është aq e rëndësishme saqë duhet vendosur në një projektion për observacionet pasi ne nuk mund të vazhdojmë të bëjmë 200 ente në vit, ju, por edhe ne, që marrim informacionin kur nuk e dimë ende se cilat janë ato me bazë risku më të mëdha dhe cilat janë ato për të cilat fokusi duhet të jetë më i lartë që të fokusohemi te cilësia dhe jo vetëm te sasia? Mund të jetë një detyrim ligjor, por 200 ente më duket një numër i konsiderueshëm për të realizuar edhe numrin edhe cilësinë kur nuk e dimë nga observacionet se cilat janë ato për të cilat duhet të marrin rolin dhe vëmendjen më të madhe, sidomos ato që krijojnë dëmin më të madh. Ju përmendët pak më parë 17 miliardë të tatimeve, të cilat duhet të jenë në riskun më të lartë, doganat, gjithashtu. Në ato institucione, vetëm në gjashtë mujorin e parë, në gjykimin tim, 80% e asaj që ju keni raportuar, ka peshë më të madhe specifike. Pra, duhet të fokusohemi te cilësia.

Së dyti, zonja Koliqi, tha se 47% janë opinione të kundërta që do të thotë se ka diçka në raport me observacionet e institucioneve për të cilat ekspertët tuaj, me gjithë vlerësimin për to dhe ju e keni përmendur në raport që ka opinione të kundërta pasi në gjykimin profesional të audituesve devijimet janë materiale dhe të tjerët e gjykojnë që nuk janë materiale. Kur ka devijime materiale ose jomateriale mendoj se në preferencë duhet të jetë standardi, ligji, nuk ka nevojë gjykimi personal qoftë i KLSH-së ose i institucionit referues në secilin nga auditimet. Në këtë pikë mund të mos jetë detyrim ligjor pjesa e dhënies së opinioneve për të ndryshuar këto standarde, por aty është fillimi i punës. Nëse ne kemi 200 raste auditimi, kemi një përqindje të lartë mospërputhshmërie, kemi gjykim profesional, hajdeni të punojmë për standardin që të ulim pjesën e gjykimit dhe vlerësimit profesional dhe të jetë standardi ligji, ndryshueshmëria. Nëse kjo nuk realizohet me entet të cilat janë subjekt i vlerësimit, të bëhet me Kuvendin e Shqipërisë. Këtu bashkëpunimi ndërinstitutional kjo marrëdhënie të realizohet deri në këtë pikë, ku edhe pesha në një moment të caktuar të jetë ndryshim i rregullave dhe standardeve dhe pastaj të vendoset pjesa e bashkëpunimit në një profil ende më të fortë.

Së fundi, sa i përket masave administrative, ju përmendët 200 masa administrative dhe mua më duket një numër shumë i vogël për atë dëm që ju relatoni. Nuk po them nëse këto janë të drejta ose të padrejta, nuk po hyj në këtë gjykim. Por nëse flasim për një dëm shumë të madh, 200 masa administrative dhe një numër të caktuar ndjekjesh penale, që nuk janë pjesë e funksionit tuaj, por e prokurorisë, për mua masat duhet të shikohet sa nga këto masa zbuten rrugës, sa nga këto masa realizohen, sepse, në fakt, nëse ka dëme të kësaj natyre, kur në përputhshmëri me standardin dhe jo me gjykimet profesionale kjo vërtetohet, atëherë masat nuk mund të jenë të zbutura. Masat duhet të jenë ekstreme, sepse veç kështu mund të jepet mesazhi i qartë i funksionit.

Gjithashtu, nuk kam parë që të ketë masa për audituesit e institucioneve, sepse ata janë filtri i parë. Kur kontrollon KLSH-ja dhe nuk ka asnjë masë për ato, po audituesit, nuk ka kuptim, sepse ata janë ekipet që duhet të parandalojnë dhe është një pjesë e mirëmenaxhimit të brendshëm. Pra, të parët duhet të jenë audituesit të cilët kanë një plan veprimi vjetor për çdo institucion dhe në fund ka masa të forta të shëndetshme sipas peshës së dëmit të krijuar, sepse, në fakt, audituesit bëjnë një plan për parandalim, por në fund ia dalin të dalin pa asnjë masë. Pra, audituesit e pushtetit qendror dhe vendor duhet të marrin masat e duhura. Ju çdo vit lini rekomandime, por ata nuk ndiqen, atëherë ka diçka që nuk shkon dhe duhet të dalin përgjegjësit duke filluar nga audituesit të drejtuesit dhe jo masa të pjesshme.

**Arben Shehu**- Ne do t'i përgjigjemi të gjitha pyetjeve. Një sqarim për masat administrative që përmendi zonja Denaj, saktësisht për numrin 200 të masave. Ne e kemi shprehur shumë qartë të rekomandimet e dhëna sipas natyrës masat disiplinore janë 1087 dhe jo 200.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Eduard Shalsi** – Zonja Marnoi.

**Shpresa Marnoi** – Sa i përket dy fatkeqësive natyrore në Shqipëri, tërmetit dhe pandemisë, si kanë rezultuar kontrollet në institucionet që lidhen direkt me pasojat e këtyre fatkeqësive, si për shembull institucionet shëndetësore, apo ato që lidhen me rindërtimin? A janë marrë parasysh vështirësitë në të cilat janë ndodhur këto institucione për të ndjekur çdo rregull ose urdhër në fuqi, duke marrë parasysh faktin që duhet vepruar më shpejt, pa pasur mundësi për të pritur kohën e nevojshme procedurale për të kryer shpenzime të ndryshme? Sepse, siç e përmendët ju, janë burokracitë që e vështirësojnë punën e këtyre institucioneve.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Marnoi!

Zonja Gjykameti.

## **Blerina Gjylameti – Faleminderit!**

Unë kam disa pyetje, për përgjigjen e të cilave do të doja të ishit teknik në përgjigje dhe të saktë, sepse mund të kuptojmë shumë më tepër si funksionon institucioni juaj, dhe, gjithashtu, edhe për interesin e lartë publik se si menaxhohen fondet publike.

Pyetja e parë që kam është për numrin e auditimeve, jo si numër në vetvete, sepse ju e përmendët gjatë prezantimit, por unë desha numrin e auditimeve që nuk kanë ndryshuar pas observacioneve. Këtu jam në vijim të pyetjes që patën kolegët e mia duke këmbëngulur fort te ndërtimi i databases, sepse vetëm duke pasur një database ne iniciojmë në ndryshime, sa i përket metodologjive, manualeve të auditimit, ose edhe në pjesën e rekomandimeve që ju duhet të jepni për institucionet e ndryshme që auditoni, ose edhe në detyrimet që keni sipas rezolutës për Kuvendin, si institucion që monitoron pjesën e institucioneve të ndryshme. Pra, SA numri i auditimeve që nuk janë ndryshuar pas observacioneve të institucioneve të audituara?

Cila është vlera e dëmit të ndryshuar, pra raporti paraprak që ju dorëzoni për observacion dhe më pas raporti përfundimtar në vlerë? Këto i dua të jenë të specifikuar.

Gjithashtu, një element që kam vënë re në kuadër të transparencës që ka institucioni juaj është se informon publikun. Në faqen zyrtare të të gjitha raporteve të institucioneve të audituara vura re diçka, 158 auditime, por të publikuara vetëm 100. Cila është metodologjia që përdorni për të përzgjedhur se cili auditim publikohet? Vura re se 12 paditë që keni bërë të 12 janë publikuara. Pse nuk publikohet edhe pjesa tjetër e raporteve? Ajo gjë që ne kemi vënë re dhe kemi diskutuar në komision është funksioni bazë ose qëllimin bazë që ka KLSH-ja që ka të bëjë me eficiencën e menaxhimit të parasë publike. A e keni vlerësuar metodologjinë e auditimit aktual? Nëse funksioni është vlerësimi i performancës dhe mirëmenaxhimi, a keni ngritur një grup pune për propozime për ndryshime të manualeve, dhe procedurave të auditimit? A keni nisur për propozime konkrete dhe rekomandimet që duhet t'i jepni Kuvendit të Shqipërisë për ndryshimet e kuadrit ligjor?

Po ashtu dëgjova pak më parë nga drejtoresha, që ndërveprojmë me institucionet, rekomandojmë, u japim informacion, u japim edhe mendim. Ndërkohë, a keni marrë masa për përmirësimin e komunikimit me institucionet që ju auditoni? Sipas mendimit tim, më shumë se sa konstatimi i dëmit, duhet parandaluar shkaktimi i dëmit.

Ne flasim për përmirësim të eficiencës dhe të efektivitetit të fondeve publike. Çfarë po bëni në këtë aspekt?

Themi gjithmonë se KLSH-ja nuk është prokurori, por ndërkohë, nëse vijojmë vetëm të konstatojmë dhe të mos sugjerojmë për ndryshime, përfundojmë vetëm në rolin konstatues

më pas, dhe jo ata që duhet të kenë një rol proaktiv për ndryshimin e të gjithë pjesës së kuadrit ligjor.

Më pas, te pjesa e praktikës së KLSH-së për kallëzimet penale, pyetja që unë kam është: a njihet masa e kallëzimit penal dhe si trajtohet nga standardet ndërkombëtare të auditimit në legjislacionin e tyre?

Në anën tjetër, dëgjova me shumë vëmendje për auditimet e performancës dhe numrit të auditimeve të performancës që janë kryer, që përbënte rreth 13,3% të totalit të auditimeve, që kryesisht janë fokusuar tek ato që kanë ndjeshmëri të lartë publike. Ndoshta jeni në një moment që do të duhet t'i rishikoni, më pas dua të kaloj te pjesa e qëndrimit tuaj dhe se si do të duhet më pas t'i kemi të reflektuara edhe në rezolutë.

Në anën tjetër, do të doja të prekja një element, që ka të bëjë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka informuar Kuvendin në lidhje me auditimin e ushtruar nga KLSH-ja në KLGJ, me fokus përlllogaritjen e pagave, vjetërsisë në punë dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në përlllogaritjen e tyre. Ministria e Financave e ka kundërshtuar rekomandimin e KLSH-së për sa i përket përlllogaritje, duke bazuar dhe duke u mbështetur në interpretim të gabuar dhe përcjell një kosto financiare, që është përafërsisht 2 miliardë lekë në buxhetin e shtetit. Do të doja të dija qëndrimin tuaj. Kjo duhet të ndërthurej edhe me pyetjet e tjera të kolegëve në lidhje me pjesën e metodologjisë, manualeve dhe pjesën e interpretimit që bëhet shpeshherë në këto procedura, që mund të mos jenë sipas standardeve, pra në pjesën e ndryshimit nga institucionet që auditohen, observacionet që bëjnë ata dhe në manualet dhe metodologjinë që ju përdorni. Ku e bazoni interpretimin e tyre për dëmin ekonomik apo, edhe pjesën e ndryshimeve apo masave që duhen ndërmarrë, që ju i vendosni në raportet tuaja përfundimtare?

Ministria e Financave thotë se KLSH-ja nuk është konsultuar paraprakisht me institucionet përgjegjëse që kanë iniciuar dhe dakordësuar aktet ligjore dhe kuadrin ligjor. Unë do të doja më shumë informacion në lidhje me këtë, sepse është një kosto shumë e lartë dhe ka ndikim shumë të madh në buxhetin e shtetit.

Po këmbëngul që nesër t'i kemi gjërat më të qarta dhe ndërkohë të shohim edhe pjesën se çfarë duhet përmirësuar rreth funksionimit. Flasim për dëme ekonomike që shkaktohen për shkak të largimit të padrejtë nga puna apo gjyqe të fituara. Kolegia Koliqi bëri disa pyetje në lidhje me procedurat që janë ndërmarrë nga KLSH-ja për largime dhe pastaj procedura, të cilat kanë rezultuar në largime të padrejta, që kanë pasur vendime të gjykatave për rikthimin në vendin e punës apo dëmshpërblim financiar. Do të doja të dija: si e interpretoni ju, në cilësinë e drejtuesve të KLSH-së, për punonjësit tuaj kur keni largime të



padrejta, dhe si interpretohet kjo më pas kur shkaktohet dhe kur gjendet dëm nga ana e audituesve të KLSH-së në institucionet që ju auditoni?

Këto ishin pyetjet e mia, ndërkohë, unë besoj se kur të kemi seancën e përgjigjeve, mund të kemi mundësi të sqarohemi më mirë dhe më pas të kemi komentet dhe qëndrimet tona.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Zoti Spaho, fjala për ju.

**Edmond Spaho** – Vetëm një pyetje kam. Marr shkas nga pyetja e koleges për largimet nga puna dhe do të doja të dija: sa janë largimet nga puna dhe fondi që paguhet për institucionet qeveritare? A keni ndonjë shifër të tillë që nga viti 2013 e deri më sot. Sa janë larguar, sa janë kthyer me vendim gjykate dhe sa është fondi që paguan buxheti i shtetit për këta punonjës?

**Eduard Shalsi** – Fjala për zonjën Tabaku edhe një herë dhe e mbyllim seancën e pyetjeve.

**Jorida Tabaku** - Kisha edhe një pyetje të fundit: cilat janë 34 institucionet që nuk kanë audit të brendshëm? Përmendni që janë 34 institucione që nuk e kanë funksionin e auditit të brendshëm, thjesht për të kuptuar nëse janë institucione të rëndësishme që menaxhojnë shumë fonde buxhetore apo janë institucione të dorës së dytë?

Zoti kryetar, së pari, më lejoni të falënderoj edhe Shërbimin e Monitorimit Institucioneve të Pavarura në Kuvend për punën që ka bërë edhe në këtë rast, edhe në rastin e Autoritetit të Konkurrencës! Ne i kemi lexuar dhe diskutuar raportet. Njëkohësisht, do të doja të falënderoja KLSH-në!

Unë besoj se i kuptoj shqetësimet e kolegëve socialistë, që duan të kundërshtojnë çdo gjë, jemi vetë në opozitë, përpiqemi të kundërshtojmë çdo gjë, por në këtë rast raporti i KLSH-së në përgjithësi, por edhe raportet e tjera, janë ndër raportet e vetme të pavarura, sepse çdo institucion tjetër i pavarur tashmë është emërim i qeverisë.

Duke shprehur vlerësime për punën, unë do të doja të kishim parasysh disa elemente, të cilat besoj se ndihmojnë Ministrinë e Financave, institucionet, por edhe disa ndryshime dhe përmirësime ligjore, amendime për ligjin për të lehtësuar punën e KLSH-së, që na shërben edhe ne deputetëve më pas kur të diskutojmë në këtë komision.

Unë dua të ngre një shqetësim, që nuk e ngrita te pyetjet e mia, për sa i përket borxhit dhe menaxhimit financiar në tërësi nga ana e Ministrisë së Financave, por edhe të gjitha institucioneve buxhetore. Shqetësimi në këtë rast lidhet me faktin që, edhe në raportin e

KLSH-së thuhet se shumica e borxhit të deklaruar nuk është reale, ndryshon me një vlerë të vogël, ndërkohë që shqetësimi kryesor është që një pjesë e madhe e kontratave të partneritetit publik-privat nuk janë të regjistruara në vlerën e tyre totale, duke krijuar pamundësi për parashikimi për institucionet buxhetore, por edhe për buxhetin e shtetit, për të pasur parasysh se sa janë detyrimet në të ardhmen e afërt. Për mua, kjo shoqëruar edhe me problemet në menaxhimin e buxhetit, vështirësitë që kanë institucionet në zbatimin e kontratave PPP, faktit që një pjesë e madhe e buxhetit të shtetit, një pjesë e konsiderueshme, është zbatuar pas datës 15 nëntor, rastet kur janë projekte të investimeve, të cilat reflektohen me vlera shumë të ulëta për t'u shtuar në vitet pasardhëse, në rastin e prokurimit publik, ku procedurat janë në shkelje të ligjit, një pjesë e madhe e tyre janë edhe me dëm ekonomik, përveç faktit që janë miratuar në limit të kohës, por njëkohësisht edhe në limit të interpretimit ligjor për sa u përket zbatimeve të këtyre prokurimeve, unë gjykoj se e kanë vendosur buxhetin e shtetit në një risk të jashtëzakonshëm. Prandaj, mendoj se qeveria shqiptare duhet ta marrë dhe ta lexojë këtë raport si një plan pune dhe të mos përpiqet të kundërshtojë çdo gjë.

Shqetësimi në lidhje me përdorimin e fondit rezervë, është një shqetësim real që është konstatuar sa herë që e kemi diskutuar në komision, ku përfaqësues të Ministrisë së Financave vendosin për përdorimin e fondit rezervë edhe paga institucionesh. Për shembull, para disa kohësh e krijuar institucioni i Agjencisë së Medies në Kryeministri, për të cilin u raportua se do të mbulohej nga fondi rezervë, përveç fondeve të COVID-it. Pra, përdorimi i fondit rezervë, si një buxhet shtesë i buxhetit të shtetit, duke anashkaluar procedurat e këtij komisioni për buxhetin e shtetit, si dhe duke shkelur me këmbë edhe vullnetin e parlamentit, për mua është shqetësuese.

Në përfundim, falënderoj kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe stafin e tij për të gjitha shpjegimet që na dhanë sot, duke shprehur se do të marrim shpjegime më të detajuara në lidhje me shqetësimet që ne ngritëm!

Unë besoj se ka vend për përmirësim për të gjitha palët, por roli i këtij komisionit, ku ne jemi anëtarë, është që t'i mbështesim dhe t'i inkurajojmë institucionet e pavarura në punën e tyre dhe jo t'i sulmojmë sa herë që na intereson ose nuk na intereson.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Tabaku!

Falënderoj të gjithë deputetët për pyetjet!

Unë kam një merak, të cilin e kemi diskutuar bashkë me kolegët e komisionit, ka një mënyrë tradicionale të mbajtjes së raporteve mes komisioneve parlamentare dhe institucioneve. Ne kemi filluar, duke dashur të jemi më aktivë dhe të mos i lëmë raportet

institucionale të shihen një herë në vit, sa herë që ka raporte, të hapim një urë komunikimi të vazhdueshme për të kuptuar akoma më mirë rolin e institucioneve, me qëllim që edhe institucionet të kuptojnë rolin e parlamentit dhe të vendosim një raport ashtu siç duhet.

Gjithashtu, ka edhe një kërkesë në raportet e Bashkimit Europian që Komisioni i Ekonomisë të ketë një nënkomision enkas për rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Siç kemi bërë me Autoritetin e Konkurrencës, me Bankën e Shqipërisë, do të bëjmë edhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit, këtu duhet kontributi i të gjithëve për ta pasuruar këtë raport dhe për ta bërë sa më të frytshëm dhe më të dobishëm.

Meraku që kam në lidhje me Kontrollin e Lartë të Shtetit është që ai institucion të mos shikohet si një gogol penalizues, por si një mbrojtës i interesave të qytetarëve, pra si një “gardian” i fondeve publike. Natyrisht, është bërë një punë e madhe në përmirësimin e rolit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por besoj se ka mundësi për ta hequr atë opinion, si një institucion penalizues.

Ne do të bëjmë edhe një rezolutë me rekomandime, e cila, në traditën e këtij komisioni, bëhet në konsultim me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Për herë të parë kemi dy relatore. Ky është një mesazh që me institucionet e pavarura, pavarësisht se ka maxhorancë, ka edhe opozitë, ne duam që të ketë një vijueshmëri në qëndrime. Prandaj, falënderoj dy relatorët në veçanti, për punën e detajuar që kanë bërë, të cilat do të ketë një raport më intensiv me Kontrollin e Lartë të Shtetit, për t’i mbajtur në vijueshmëri raportet dhe jo një herë në vit!

Pyetjet, pavarësisht se janë mbajtur shënim, do të zbardhen dhe pastaj do të rakordojnë në një datë të përshtatshme, edhe për ju, edhe për ne, si komision, në mënyrë që të vijojmë me përgjigjet.

Fjalën e ka zonja Zake, pastaj relatorja, zonja Koliqi, nëse ka ndonjë merak, por në fjalën e tyre do të donim një koment përmbledhës të fundit.

**Enslmvera Zake** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë që në fillim të fjalës sime e vlerësova punën voluminoze jo vetëm të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe të drejtorive përkatëse, të cilat janë shtyllat mbështetëse të këtij institucioni, që ne na ndriçojnë dhe na orientojnë jo vetëm për përmirësimin e punës sonë me shërbimet e Kuvendit, por edhe me institucionet që ato autidojnë dhe u vijnë në ndihmë.

Ne, siç e tha edhe kryetari, kemi disa pyetje, një pjesë e të cilave i ezauruan, por do të ishte mirë, edhe për kolegët ,që përgjigjet e pyetjeve të tjera të vijnë me shkrim dhe në takimin e radhës ne të marrim përgjigjet.

Bashkë me relatorin ne kemi përgatitur edhe disa rekomandime paraprake, të cilat do të vijnë në formën e një rezolute, por duke përfshirë edhe rekomandimet e tjera të kolegëve, që dolën gjatë mbledhjes së sotme. Më pas do të jemi në kontakt të vazhdueshëm me Kontrollin e Lartë të Shtetit, në mënyrë periodike, për të parë raportet periodike të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe për të përmirësuar punën dhe për të gjetur ura lidhëse të përbashkëta në përmirësim të punës, por edhe me institucionet që janë objekt i këtij auditimi.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Zake!

Po, zonja Koliqi.

**Emilia Koliqi** – Edhe unë e vlerësoj punën voluminoze të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sepse me rritjen e numrit të auditimeve, patjetër që rritet edhe volumi i punës, pavarësisht se nuk ka qenë i plotësuar, të paktën gjatë vitit 2021, me stafin e nevojshëm për kryerjen e të gjitha procedurave të auditimit.

Dua të theksoj se vlerësimet që ka marrë Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe nga organizata e Kombeve të Bashkuara, ku nga një sondazh ato priren të besojnë se mekanizmi më efikas i llogaridhënies në vend është KLSH-ja. Pra, është një institucion i besueshëm dhe ka një përqindje prej 60,7% në sondazhin e përgjithshëm.

Përveç kësaj, KLSH-ja ka marrë vlerësim edhe nga progresraporti i Komisionit Europian.

Cilësia e punës audituese duhet përmirësohet, për të qenë plotësisht në përputhje me standardet e “INTOSAI-t”. Pavarësisht shkallës së lartë të rekomandimeve, të pranuar nga institucionet, shkalla e zbatimit të plotë të rekomandimeve duhet të përmirësohet. Gjithashtu edhe ndjekja e kallëzimeve penale duhet të shkojë deri në fund, për të marrë edhe dënimet, nëse ka propozime të sakta.

Ne do të punojmë bashkë për rezolutën, siç e tha edhe zonja Zake, do ta konsultojmë bashkë për rekomandimet dhe të konkludojmë në vijim të punës së përbashkët.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Koliqi!

Zoti kryetar, a doni të thoni diçka?

**Arben Shehu** – Nuk kam diçka të veçantë për të shtuar, por dua t’ju falënderoj për mundësinë dhe për vëmendjen!

Gjithashtu, dua të rikonfirmoj edhe një herë gatishmërinë për të vënë në dispozicion të plotë dhe në mënyrë të detajuar të gjitha përgjigjet për pyetjet e ngritura nga të gjithë anëtarët e komisionit, në limitin që do të përcaktoni ju.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Për çështjen e dytë, për miratimin e rezolutës së Autoritetit të Konkurrencës, një kolege e nderuar ka kërkuar më shumë kohë. Drafti me të vërtet ka ardhur dje, por ka ardhur me shumë pak ndryshime, pra është pak a shumë drafti i vjetër, por gjithsesi ne do t'ju japim kohë ta shihni, ta gjykoni, nëse ka ndonjë propozim për të bërë për tekstin, ju lutem, depozitoheni, por do të ishte mirë që ta mbyllim brenda javës që vjen.

A jeni dakord? Dakord.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Jo, nuk kemi votim.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e komisionit**

**Enslemvera Zake**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Sekretar Administrariv**

**Elvi Prifti**